

"Të injorosh të shkuarën, do të thotë të mbetesh gjithmonë fëmijë" - CICERONI



Dukagjini

Botim Periodik i Shoqatës Atdhetare "Dukagjini", Viti i XII i botimit, nr. 139, maj 2015
Nr. Llog. UNIONBANK 510367047020112, Shkodër - Albania, Tel. 00355692465784, internet: www.shoqatadukagjini.com, Kryeredaktor: Luigj Shyti, Çmimi 30 lekë / 1.5 euro

ZHVILLIMI I ZONËZ SË DUKAGJINIT - DOMOSDOSHMËRI PËR TË GJITHË BASHKINË SHKODËR

2

LETËR E HAPUR

KANDIDATËVE PËR KRYETARË TË BASHKISË SHKODËR

+ Së pari ju urojmë suksese ne angazhimin tuaj në të mirë të komunitetit të Bashkisë Shkodër.

Po ju shkruajmë për një zonë të Bashkisë Shkodër, për të cilën kemi një shkallë njohurie të mjaftueshme. Kjo zonë është Dukagjini. Dukagjini, që e dini se ku bie, ka mundësi dhe rezerva shumë të rëndësishme shoqërore, historike, natyrore, turistike, por dhe ekonomike...

Një ditë në shkollën 9 vjeçare Bardhaj

Jo gjithnjë ndryshimet e drejtuesve të shkollave e japin pritshmërinë, sepse shumëherë dominon militantizmi e jo meritokracia. Në shkollën 9 vjeçare Bardhaj ka ndodhë krejt e kundërta. Ka një vit që drejtimi i kësaj shkolle i është besuar të palodhurës, autoritares dhe profesionistes znj. Tereze Brigja. Falë vitalitetit e perkushtimit të saj për ta justifikuar besimin e dhënë, sot shkolla 9 vjeçare Bardhaj ndryshon si nata me ditën krahasuar me një vit më parë, duke filluar që nga krijimi i kushteve të përshtatshme për mësim, eliminimi i çdo të keqeje që vjen nga jashtë, rritja e mobilizimit të kolektivit mësimdhënës duke çuar në vend autoritetin e mësuesit, që në shumë shkolla është më i nëpërkëmbur... / Prelë Shytani

5

FERID FRASHËRI DHE SAKRIFICA TRAGJIKE SI MBROJTËS I AHMET ZOGUT?!

SI E VRAU GJELOSH MARKU FERID FRASHËRIN?!

Ferid Frashëri ishte një oficer karriere i devotshëm, thellësisht i politizuar, i vënë në shërbim të politikës dhe i përfshirë në krahun kombëtar. Në gjysmën e parë të viteve njëzet mbante gradën e Kapitenit dhe ka dhënë kontribut të vyer në krijimin e një klime të qëndrueshme politike duke qënë partizan i linjës së grushtit të nokautit... / Prelë Milani

NË TUZ, MES HISTORISË DHE HARRESËS ...

Me Ramazan Çeken, poetin e gazetarin shkodran, udhëtojmë drejt Tuzit, qytetit shqiptar në Malin e Zi, më pak se 10 km nga pika kufitare e Hanit të Hotit. Në shoqërinë tonë është Gjon Dushaj, kryetari i shoqatës "Ded Gjon Luli", një djalë me shpirt artisti por edhe një veprimtar i njohur për çështjen shqiptare. Ka trembëdhjetë vite që drejton shoqatën dhe ansamblin folklorik me të njejtin emër por na thotë... / Sejmen Gjokoli



DUKAGJINASI, LIN DEDE GURI, MIRENJOHJA E QYTETIT SHKODER



Me datën 22 maj 2015, në holin e Tearit "Migjeni", u zhvillua ceremonia e dorëzimit të titullit "Mirenjohja e qytetit Shkodër", zotit Lin Dede Gurit. Në këtë ceremoni morën pjesë familjare e miq të Lin Gurit, mori pjesë deputetja Jozefin Topalli, kryetari i Bashkisë së qytetit Shkodër, ... / Prelë Milani

PARADOKSE TE QYTETIT TIM

4

FLAMUJT E GASPER TRAGAÇIT

"Very silly are albanian!". Kjo ishte shprehja e një çifti anglez, që me sa duket kishin ardhur si turistë në Shkodër, tek po kalonin afër ish Pesë Heronjëve. E përkthyer në shqip do të thotë: Shumë budallenjë janë shqiptarët! E gjitha kjo falë vetëm hasasë që po shikonin nga prania e mijra e mijra flamujve të të gjitha ngjyrave që përfaqësonin gjithë spektrin politik të vendit tonë. Sa shumë flamuj! Sa shumë parti! Sa shumë ...! Sa shumë...! E ne... sa pak! Sa pak! Shkodra nën hijen e flamujve. Rrugë që u ngjajnë tunelave të errëta. Pushtet absurd i ngjyrave. Dhunë e mirëfilltë psikologjike. Tundim e depresion... / Lazër Kodra



ZHVILLIMI I ZONËZ SË DUKAGJINIT - DOMOSDOSHMËRI PËR TË GJITHË BASHKINË SHKODËR

LETËR E HAPUR

KANDIDATËVE PËR KRYETARË TË BASHKISË SHKODËR

Së pari ju urojmë suksese ne angazhimin tuaj në të mirë të komunitetit të Bashkisë Shkodër.

Po ju shkruajmë për një zonë të Bashkisë Shkodër, për të cilën kemi një shkallë njohurie të mjaftueshme. Kjo zonë është Dukagjini.

Dukagjini, që e dini se ku bie, ka mundësi dhe rezerva shumë të rëndësishme shoqërore, historike, natyrore, turistike, por dhe ekonomike.

Në këtë territor jeton një popullsi me cilësi shumë të qëndrueshme që ka bërë të mundur ti rezistojë fuqishëm kohës, kushteve sociale, politike dhe natyrore. Kjo e ka bërë këtë komunitet që të jenë i aftë për tu përshtatur kushteve, për të mbi jetuar, për të gjetur rrugëzgjidhje për momentin por dhe afatgjatë.

Pas viteve '90 ka pasur një emigrim të fuqishëm për në zonat fushore, qytete të ndryshme të Shqipërisë, por edhe në shumë vende të ndryshme të botës. Kjo ndodhi nga dëshira për një jetë më të mirë, por ky emigracion masiv u nxit edhe për faktin se edhe ato kushte që ishin u dëmtuan pothuaj fare dhe vërtetë nuk mund të jetohej as në kushte minimale.

DREJTIMI KRYESOR I PUNËS NË KËTË ZONË ËSHTË DHE DUHET TË JENË:

- KRIJIMI I MUNDËSIVE TË PUNËSIMIT
- NDALIMI I SHKRETIMIT TË KËSAJ ZONE
- KRIJIMI I MUNDËSIVE PËR RIPOPULLIMIN E SAJ

Kjo kërkon një angazhim frontal, por, disa përparësi mendojmë se janë:

1 Përmirësimi i infrastrukturës rrugore, veçanërisht asfaltimi i rrugës Qafë e Tërthores-Theth-Breglumi-Shosh-Kir-Prekal, por fillimisht Qafë e Tërthores-Theth dhe Prekal Kir.

2 Realizimi i furnizimit me ujë të pijshëm i të gjithë banorëve. Mbështetje për rindërtim dhe ndertim kalash ujitëse në shërbim të fermerëve.

3 Rikonstruksioni i sistemit të prodhimit dhe transmetimit të energjisë elektrike në këtë zonë.

Nxitje për shfrytëzimin e ujërave duke ndërtuar hidrocentrale të vegjël që mund të jenë shumë ekonomik.

4 Ngritja e niveli shkencor dhe metodik në shkollat e zonës, veçanërisht në shkollën e mesme Breglumi, duke mbështetur me subvencione mësuesit që punojnë aty, rikonstruktimi i shkollave dhe vënia në gjendje normale. Rritja e kapaciteteve dhe bashkëpunimit me komunitetin për të mbështetur shkollën dhe punën e saj.

5 Vendosija në funksion të shërbimit shëndetësor dhe në veçanti vënia në punë e spitalit në Breglumi me specialist më të domosdoshëm.

6 Mbështetje me kredi të buta për banorët e kësaj zonë për rindërtimin e shtëpive të dëmtuara këto vitet e fundit. Gjithashtu mbështetje për zhvillimin e kulturave bujqësore, blegtorinë, pemëtarinë, për të pasur prodhim plotësisht bio. Mbështetje edhe me trajnime e kualifikime për banorët.

7 Menaxhimi i kualifikuar i pyjeve, kullotave dhe i kafshëve të egra që jetojnë në to.

8 Zhvillimi i mëtejshëm i turizmit është prioritet në këtë zonë. Ai është shumë e nevojshme të mbështetet me kredi të buta dhe afatgjatë për ndërtimin e infrastrukturës së pritjes dhe akomodimit të turistëve. Nxitje dhe mbështetje për të ushqyerit bio dhe tradicional. Turizmi është i domosdoshëm dhe i mundur në të gjithë këtë zonë pasi ka mundësi të shumta. Kjo mund të realizohet duke zhvilluar infrastrukturën rrugore me të gjithë elementët e saj nga Prekali dhe deri në Theth, duhet mbështetur ngritja e kapaciteteve për kushtet dhe shërbimin e pritjes dhe përcjelljes së turistëve.

9 Krahina e Dukagjinit ka rezerva të pallogaritshme historike, arkeologjike dhe etnografike. Në këtë zonë janë tri kështjella të mesjetës, pse jo edhe më të hershme, ka vendbanime rreth 3000 vjeçare, ka qafa e male që bartin në gjirin e tyre histori, legjenda, këngë, përralla, vegla muzikore, valle, etj. Në vitin 1454 Gjergj Kastrioti

vjen në Kështjellën e Dakajve, në Shalë. Ka ura të bukura dhe interesante, qafa malesh të përshtatura nga dora e njeriut për ti kaluar.

Është e domosdoshme projektet dhe mbështetja për to, në mënyrë që të mos zhduket historia. Duhet nxitur dhe mbështetur, studiues dhe shkrimtar që të pasqyrojnë sa më mirë dhe më thellë këtë histori që ruli i globalizimit mund të fshijë. Jo të shkruhet nga dritarja e pallatit, pra nga larg, por të shëtitet më këmbë, të preket me dorë, të dëgjoen më veshë çfarë mund të dëgjoen dhe të shikohen me sy të paktën ajo që ka mbetur.

10 Vlerat natyrore të kësaj zone janë të pallogaritshme, por edhe të pa përsëritshme. Njohja e dhe publikimi i tyre shton numrin e vizitorëve, rritë mundësinë e zhvillimit të kësaj zonë, rritë vlerat për të ardhmen. Në këtë zonë ka shpella shumë interesante, ka llojshmëri shumë të madhe të bimësisë, midis të cilave ka shumë bimë mjekësore, bimë të egra të ngrënshme dhe bimë ngjyruese. Nxitja e studimeve në këtë drejtim, zhvillimi i eksperimentave, ekskursioneve me të rinjtë, shton dashurinë për këtë zonë, por dhe zhvillimin.

11 Është domosdoshmëri nxitja e nxënësve për studime në të gjitha shkollët dhe llojet e shkollave. Koha ka treguar se nxënësit nga kjo zonë, në shumicën dërmuese kanë qenë shumë të mirë në studime. Kjo do të rritë nivelin arsimorë kulturorë të komunitetit.

12 Prej rreth 25 vitesh, masivisht familje nga Dukagjini nuk janë pronar ligjor të pronës së tyre në atë zonë, sipas ligjit në fuqi. Është shumë urgjente legalizimi i saj pasi nuk mund të bëhen investime, gjë e cila pengon zhvillimin, tregun, etj.

13 Alpet Shqiptare, në të cilat shtrihet Dukagjini, kanë vlera të shumta. Këto Alpe meritojnë vëmendje dhe vlerësim nga të gjithë. Do të ishte me vlerë shumë të madhe kënaqësia dhe publiciteti, që në respekt të tyre, por edhe për njohjen dhe rritjen e frekuentimit të tyre, ngritjes më lart të turizmit në këtë zonë, tërheqjen e vizitorëve, të organizohen një festa "Dita e Alpeve Shqiptare" në mënyrë të përvitshme në Theth, në një ditë në muajin gusht pasi kthehen edhe

shumë emigrantët. Përvoja ka, dhe mundësitë janë. Kjo do të rriste vlerat turistike dhe publicistike gjithë zonës, por edhe gjithë Bashkisë Shkodër.

14 Besimi dhe shërbimi fetar, në këtë zonë, është qindra vjeçar. Priftërinjtë dhe rregulltarët e kishës kanë qenë dhe janë pranë njerëzve në edukimin e shkollimin në përgjithësi dhe atë shpirtëror në veçanti. Bashkëpunimi i dyanshëm, religjion fetar – bashki, do të shërbente akoma më shumë për edukimin me tolerancën, uljen apo shuarjen e grindjeve, ngatërresave, vrasjeve dhe gjakmarrjes.

15 Ka ardhur koha që të gjitha rrugët, qendrat historike, kulturore dhe fetare të tregohen më tabela, pse jo edhe një përshkrim i shkurtër rreth tyre.

16 Është shumë e nevojshme që të nxitin dhe mbështeten projekte për krijim e lagjeve etnografike, pasi baza kryesore ekziston. Me punë dhe kujdes mund të realizohen shumë bukur, si për shembull në lagjen Mekshaj në Nënnavriq, në Kir, por edhe në fshatra të tjerë.

17 Nxitja dhe mbështetja e përgatitjes dhe shpërndarjes së një guidë turistike, të plotë. për zonën e Dukagjinit.

18 Është shumë e nevojshme që të mundësohet vendosja e pllakave përkujtime, disa prej të cilave po i përmend:

- a. Mbi vizitën e Gjergj Kastriotit në Dakaj-Shalë në vitin 1454
- b. Në Themelet e Kishës së Shtjefnit në Breglumi, Shalë.
- c. Në Kështjellën e Dakajve-Shalë.
- ç. Në Kështjellën e Qereshit-Pult.
- d. Në kështjellën e Kirit-Pult.
- e. Vendbanimi rreth 3000 vjeçar në Theth.
- f. Te Ura e Shalës ku kaluan 1500 ushtarë Malazet në vitin 1915 në dy pushkë të kulmuara.
- g. Për thyerjen e ushtrisë Osmane në Qafën e Agrit në vitin 1910.
- h. Te Kisha e Thethit për ndërtimin e saj 1892 dhe rikonstruksionin e saj nga bashkatdhetarët me banim ne Amerikë.
- i. Në afërsi të Kishës në Theth për hapjen e shkollës së parë në Dukagjin nga At Shtjefën Gjeçovi në vitin 1917.
- j. Në shtëpinë ku është lindur At Daniel Gjeçaj në Theth.

19 Në të gjithë punën për zhvillimin e zonës së Dukagjinit të

bashkisë Shkodër, është e domosdoshme integrimi dhe përfaqësimi shumë më i mirë së deri tash i banorëve të rinj në jetën politiko, shoqërore dhe administrative të Bashkisë Shkodër. Kjo do të bëjë të mundur thithjen e mbështetjes së tyre në pjesëmarrje dhe mbështetje në votime, do të mundësojë zhvillim, përparim, mirëkuptim dhe tolerancë.

20 Mendoj, që në kuadrin e përgjithshëm të programit tuaj, të ishte edhe një program konkret rajonal zhvillimi për zonën e Dukagjinit.

Programet rajonale do të ishin jo vetëm të nevojshme, por të domosdoshme edhe për zona të tjera, pasi Bashkia e Shkodrës mund të rajonizohet për efekt studimi dhe planifikimi sipas territorit dhe mundësive të zhvillimit. Programet rajonale do të krijojnë mundësinë e programeve dhe premtimeve konkrete dhe po ashtu edhe mundësinë e kërkesës për realizimin e tyre. Bashkimi i programeve rajonale do të bënte programin përgjithshëm të bashkisë, të lexueshëm, konkret mbi bazën e nevojave parësore dhe mundësitë të zhvillimit, por dhe të mundshëm për tu realizuar, dhe për tu kontrolluar.

Interesimi, nxitja dhe mbështetja për këtë zonë është shumë e rëndësishme. Vlerësimi i problemeve të kësaj zone, disa prej të cilave u përmenden këtu, është me vlera për sot dhe për të ardhmen. Mbështetja e kësaj zone nga Ju që kërkoni të drejtoni Bashkinë Shkodër do të gjëjnë mbështetjen nga komuniteti dukagjinasi. Duam të besojmë në kthimin e syve në drejtim të kësaj krahinë, veçanërisht në këtë kohë që u bë edhe riorganizimi territorial e administrativ dhe mundësitë janë më të mëdha.

Me respekt
Ndue SANAJ
Kryetar i Shoqatës
"Atdhetare Dukagjini"

Luigj SHYTI
Kryeredaktor
i gazetës "Dukagjini"

Shkodër, më 11 maj 2015

KOMUNIKATË Nr. 2

MBI ECURINË E PUNËS PËR VENDOSJEN E PËRMENDOREVE TË ATDHETARIT MEHMET SHPENDIT DHE ALBANOLOGUT MARTIN CAMAJT NË SHKODËR

Kryesia e Shoqatës "Atdhetare Dukagjini" e gjen me vend që të njoftojë anëtarët e shoqatës, dashamirët, dhuruesit për grumbullimin e fondeve financiare si dhe gjithë opinionin publik, mbi ecurinë e mbledhjes së deri tashme të fondeve, si dhe punën që po bëhet për përgatitjen dhe vendosjen e shtatoreve të Mehmet Shpendit dhe Martin Camajt në qytetin Shkodër.

Falë kuptimit dhe mbështetjes nga shumë dukagjinan, por edhe jo dukagjinan, si brenda edhe jashtë atdheut, është bërë një punë mjaftë e madhe që na kanë mbushur me gëzim dhe krenari, por edhe më besim do të bëjmë realitet këtë mision në kohën e duhur. Ne u shprehim mirënjohjen dhe gjithë respektin tonë të gjithë atyre që me bujarisht shembullore, me thjeshtësinë dhe ndjenjën e ndihmës dhe përkrahjes për vendlindjen dhe figurat e saj, për historinë dhe kulturën e saj, për transmetimin e tyre tek brezi i ri dhe ata që vinë.

Në dhurimin dhe grumbullimin e fondeve, për këto përmendore, morën pjesë 149 veta, një pjesë nga të cilët edhe familjarisht si brenda dhe jashtë atdheut. Nga këto dhurime u mbledhën deri në këtë moment, 62783 Euro. Krahasuar me projektin, nga këto dhurime janë realizuar rreth 77% të projektit. Pjesa tjetër pritet që të grumbullohet.

Ne, me respekt dhe përlulsi falënderojmë të gjithë ata që kanë ndihmuar dhe do të ndihmojnë në këtë drejtim, por është për tu theksuar me konsideratë shumë të lartë, se, në ballë të dhuruesve qëndrojnë bashkatdhetarët tonë nga Neë Jorku të cilët me organizim të përsosur, me thjeshtësi dhe respekt, kanë mundësuar mbi 72% të ardhurave të mbledhura deri tash, ose rreth 57% të të gjithë projektit. Mirënjohja dhe respekti për ta është i merituar.

Është vendi që të falënderojmë nga zemra edhe ata dhurues jo dukagjinan që janë bërë pjesë e rëndësishme në mundësimin e realizimit të kësaj detyre që i kemi vënë vetes. Gjithashtu me shumë respekt falënderojmë ata qytetarë amerikan që me ndjenjën e respektit për vendin e origjinës së tyre janë bërë pjesë mjaftë e rëndësishme në grumbullimin e këtyre fondeve, ndonëse, të parët e disa prej tyre, janë larguar prej mbi gjashtë brezash nga trojet amtare, nga Dukagjini.

Duhet thënë se misioni ka nevojë përsëri sepse nuk janë grumbulluar fondet e nevojshme. Kemi besim të plotë në vazhdimin e mbështetjes deri në mblylljen me sukses të plotë të tij.

Të dashur vëllezër dhe motra!

Ka përfunduar ngritja me baltë dhe në datën 15 maj do të filloj derdhja në allçi e shtatores së atdhetarit Mehmet Shpendit, dhe nga fillimi i muajit qershor do të fillojë derdhja në bronz. Rreth datave 25-30 qershor do të jenë gati për tu vendosur në vendin e caktuar. Është miratuar nga Këshilli i Bashkisë Shkodër vendi i vendosjes së kësaj përmendoreje. Ky vend është në sheshin e zonës industriale të qytetit të Shkodrës. Presim që së afërmi të miratohet edhe vendi i vendosjes së shtatores së albanologut Martin Camajt, për të cilin janë bërë propozimet përkatëse. Me mbarimin e punës me baltë dhe allçi të shtatores së Mehmet Shpendit do të fillojë puna për shtatoren e Martin Camajt.

Të gjithë së bashku, duhet dhe do të realizojmë këtë mision, jemi besimplotë se do të grumbullohen sasia e nevojshme financiare për plotësimin e tij.

Me respekt dhe përlulsi për të gjithë dhuruesit pa përjashtim, por dhe me dëshirën për të qenë së bashku në përuarimin e këtyre përmendoreve në kohën e përcaktuar në projekt.

KRYESIA E SHOQATËS ATDHETARE DUKAGJINI
Shkodër, 09.5.2015

2003-2015 12 VJET SHOQATA "ATDHETARE – DUKAGJINI"

Anëtar e anëtare të Shoqatës "Atdhetare-Dukagjini", miq të Shoqatës "Atdhetare-Dukagjini", Shoqata e jonë, nesër mbush 12 vjet nga themelimi i saj. Vjen në këtë përvjetor me shumë arritje.

Për të pasur më të qartë jetën e saj 12 vjeçare, po japim një histori të shkurtër të rrugës së saj:

Shoqata "Atdhetare-Dukagjini", me moton: "Mos pyet se çfarë bëri Dukagjini për ty, por çfarë unë bëra për Dukagjinin", u themelua me 6 prill 2003 dhe u miratua në gjykatën e shkallës së parë -Tiranë, me vendim Nr. 666, date 13 maj 2003.

MISIONI

Duke u mbështetur në historikun e së kaluarës dhe të sotmes, duke respektuar ndjenjat dhe sakrificat e të parëve për liri, pa varësi dhe përparim shoqëror, Dukagjini të zërrë më mire vendin që meriton në botën e qytetëruar e moderne.

Gjate këtyre viteve, veprimtaritë kryesore janë:

1- Janë përgatite dhe zhvilluar gjashtë simpoziume dhe një seminar shkencor "Dukagjini në rrjedhat e historisë":

1.1- I pari, kushtuar 85 vjetorit të Besës së Prekalit, me temë "Kuvendet malësore dhe koha", mbajtur më 19 Nëntor 2004;

1.2- I dyti, kushtuar 95 vjetorit të Luftës së Qafës së Agrit, 90 vjetorit të Luftës së Planit dhe 90 vjetorit të rënies së heroit të Dukagjinit, Mehmet Shpendit, me temë "Traditat patriotike dhe liridashëse të dukagjinave në vitet 1890 - 1920", mbajtur me 25 Shtator 2005;

1.3- I treti, kushtuar 100 vjetorit të lindjes së një figure të mëdhe të Dukagjinit dhe të Shqipërisë, At' Jak Marleka (prof. dr. Luigj Marleka), me temë "Një misionar në Shërbim të Kombit", mbajtur me 24 Nëntor 2006;

1.4- I katërti, kushtuar vlerave materiale dhe shpirtërore të dukagjinave, me temë: "Kultura materiale e shpirtërore", mbajtur me 24 nëntor 2007.

1.5- I pesti, kushtuar femrës dukagjinase, me temë: "Femra dukagjinase në kohë", e mbajtur me 7 Dhjetor 2008.

1.6- I gjashti kushtuar gjakmarrjes, me teme: "Gjakmarrja retorike apo realitet", në bashkëpunim me Komisionin Drejtësi e Paqe, me 11 dhjetor 2010

1.7- Seminar është zhvilluar me teme: "Drejtimet e mundshme të zhvillimit të Dukagjinit", me 3 maj 2008.

1.8- Konferencë përkujtimore, në kuadrin e 100 vjetorit të Shpalljes së Pavarësisë, në bashkëpunim me shoqatën "Martin Dreshaj", me qendër në Peje, me 21 prill 2012, në "Fshatin e Paqes", në Shkodër

2- Përgatitur dhe nxjerrë çdo muaj, duke filluar nga muaji Dhjetor 2003, gazetën e shoqatës, me emrin "Dukagjini", gjithsej 138 numra, dhe në fund të këtij muaji del numri 139.

3- Janë promovuar 55 libra të autoreve dukagjinan, që kanë shkruar kryesisht dukagjinanit për Dukagjinin

4- Me grupin artistik të Dukagjinit, janë organizuar dhe mbështet nga Kryesia e Shoqatës realizimi i 10 mbrëmje argëtuese, në kuadrin e festave të fund vitit, të Krishtlindjes, të vitit të ri dhe të Pashkëve.

5- Me këngëtarët dhe krijuesit më të mire të Dukagjinit, u përgatit dhe u dha koncerti folklorik "Folk – 2007", me rastin e Pashkëve në Teatrin "Migjeni", me pjesëmarrjen e Artistes së Popullit – Tinka Kurti, artistit të Merituar Lazer Filipi, regjisorit dhe aktorit Bruno Shllaku, aktore Drande Xhaj, muzikologut Bardhyl Hysa dhe koreografit Aldo Nika. Ajo u zhvillua me 7 Prill 2007.

Një koncert i tillë, i titulluar "Folk - 2008", me 27 dhjetor 2008, "Folk - 2009", me 23 dhjetor 2009, dhe "Folk - 2010" të mbështetur nga Kryesia e Shoqatës, janë dhënë në Teatrin "Migjeni".

6- Janë hapur: Ekspozita fotografie e titulluar "Kontrast" e fotografëve amator Luigj Shyti dhe Luigj Mila, që u hap me 10-14 maj 2007. U përgatitë dhe u ekspozua puna e 18 piktove dukagjinan, midis të cilëve Piktorët e mëdhenj Zef Shoshi dhe Ndoc Gurashi, që u hap me 13-17 maj 2008.

7- Janë përgatitur dhe zhvilluar 14 ceremoni përkujtimore, kushtuar figurave dhe personaliteteve dukagjinan.

8- Janë botuar 2 libra të Shoqatës, me titull "Dukagjini në rrjedhat e historisë", 1 dhe 2. I pari përmban materialet e simpoziumit shkencor "Kuvendet malësore dhe koha" dhe "Traditat patriotike dhe liridashëse të dukagjinave në vitet 1890 – 1920", ndërsa e dyti përmban materialet e simpoziumit shkencor "Një misionar në shërbim të kombit". Është bërë gati për botim libri i trete, i katërt dhe i pesti i kësaj serie, por jemi në pritje të mundësorëve për botim.

9- Në bashkëpunim me Qendrën e Gruas "Hapat e Lehte", në muajin Nëntor 2007 dhe 2008, kemi zhvilluar dy veprimtari, me temë "E bukur por e ndryshme", që në thelb ishte puna që bëhet

për integrimin e banorëve të ri, që kanë ardhur nga malësitë në mjedisin qytetar në lagjen "Mark Lula" të qytetit të Shkodrës.

10- Bashkëpunim me Shoqatën e Miqësisë Kosove-Malësi e Madhe "Martin Dreshaj", me qendër në Pejë, me datën 3-4 tetor 2009, në Shkodër, zhvilluam një veprimtari kulturore e artistike, me temë: "Të gëzojmë së bashku", duke përdorur sloganin: "Jemi vëllezër, qeshim dhe qajmë së bashku". Gjithashtu, jemi pjesëmarrës në Manifestimin "Zëri i Vëllazërimit- 2010", në kuadrin e 10 vjetorit të Shoqatës së miqësisë Kosove-Malësi e Madhe "Martin Dreshaj"; me datën 24-25 prill 2010, në Pejë-Istog dhe Deçan, si dhe në manifestimin "Zëri i Vëllazërimit-2011", në kuadrin e 100 vjetorit të fillimit të kryengritjes anti-osmane dhe ngritjes së Flamurit në Deçan, me 6 prill 1911, me datën 16-17 prill 2011 në Prizren, Deçan dhe në Istog; në kuadrin e 100 vjetorit të Shpalljes së Pavarësisë me 21-24 prill 2012, në Shkodër, në Pejë, në Klinë, në Istog dhe në Deçan; me datën 24-25 prill 2013, me datën 25-26 prill 2014 dhe me datën 12-13 prill 2015.

11- Me ftesë të Ansambllit "Dedë Gjon Luli", në Tuz, morëm pjesë në 10 vjetorin e Lumnimit të Nënë Terezës, me 10 tetor 2013.

12- Në bashkëpunim me Fototekën "Marubi", me datën 15 shkurt 2014, hapëm ekspozitën "Shan Pici-1938", i cili ka qenë fotograf i apasionuar pas natyrës dhe nga 110 fotografi që u ekspozuan, 83 foto ishin të realizuara nëpër Dukagjin.

13- Me ftesë të përgjegjësit të Muzeut etnografik "Shtjefen Ivezaj" në Tuz, kemi marrë pjesë në 12 vjetorin e krijimit të tij, me 1 maj 2014.

14- Me datën 17 maj 2014, promovuam dokumentarin "Misteri i një Kreshte", te autorit Mhill Vata.

15- Me datën 13 dhjetor 2014, u zhvillua ceremonia e promovimit të librit, me titull "Dukagjini, rrugëtim në gjenezës", me autor Luigj Shyti.

Jemi themelues të Klubit Shqiptar të Medias; të Grupit Lokal të Veprimit "Bjeshkët e Namuna" dhe të Grupimit "Aleanca për Jetën", me qendër në Shkodër.

Gjatë kësaj periudhe kemi arritur të dekorohen: Albanologu Martin Camaj e Piktori Lin Delija, me urdhrin "Nderi i Kombit", atdhetari Mehmet Shpendi u dekorua me Medaljen e Artë të Shqiponjës. Gjithashtu u arrit të nderohen disa personalitete dukagjinase me titullin "Qytetar Nderi" dhe Mirënjohja e Qytetit të Shkodrës".

Viti 2015 na gjen në valën e punës për realizimin dhe vendosjen e përmendoreve të Atdhetarit Mehmet Shpendi dhe Albanologut Martin Camaj në qytetin Shkodër. Këto dy figura janë nga më përfaqësueset jo vetëm për Dukagjinin por edhe gjithë vendin tonë.

Realizimi i kësaj nisme do të bëhet realitet në saj të solidaritetit mbarë dukagjinan, veçanërisht të vëllezërve dhe dashamirësve të Dukagjinit dhe këtyre dy figurave, në Neë Jork, Miçigan, por edhe kudo ndodhen brenda dhe jashtë Atdheut nëpërmes ndihmave të tyre financiare. Realizimi i kësaj nisme krijon mundësinë dhe përvojë shumë të rëndësishme për te ecur përpara, çka, jo vetëm është një obligim i madh për secilin anëtar shoqate, por dhe për miqtë dhe dashamirët e saj.

Gjithë këto arritje të Shoqatës, nuk do të ishin realizuar pa mobilizimin këmbëngulës dhe ta vazhdueshëm të Kryesisë së Shoqatës dhe gjithë anëtarëve dhe bashkëpunëtorëve të saj, nuk do realizoheshin pa mbështetjen financiare të Dukagjinave, që nuk janë pak, por 365 vete gjatë këtyre viteve. Prej tyre mund të veçojmë: Dukagjinanit e të tjerë në Neë Jork, Miçigan, Bruksel, Gjergj Leqejzen, Ndue Ftonin, komunën e Pultit, Mhill Prroni, Pal Gjollaj, Pal Lera, Gjergj Vocaj, Kolë Çardaku Prënda Shpendi, Martin Bardhoj e shumë e shumë të tjerë, të cilët i kemi uruar dhe i urojme me gjithë thellësinë e zërrës: "Ju rritët ndera dhe paçin faqen e bardhë"

Me rastin e 12 vjetorit të themelimit të shoqatës, Kryesia uron ta gëzojmë festën e themelimit të saj dhe me faqe të bardhë në realizimin e misionit të saj.

GËZUAR!

KRYESIA E SHOQATËS "ATDHETARE-DUKAGJINI"
Shkodër, më 12 maj 201

EDITORIAL

“KUSHTRIMI” I MONUMENTEVE QË PO “VDESIN”

Restaurimi dhe mbrojtja e monumenteve të kulturës është domosdoshmëri. Njohja dhe mbrojtja e tyre, tregon sa ne jemi të interesuar për të njohur vetë, por edhe për tu lënë brezave që vinë të njohur historinë dhe kulturën e tonë. Edhe pse këtë kaluan shumë e shumë ushtri pushtuese e regjime gjakatare e grabitëse, përsëri kanë mbetur në tokën shqiptare shumë dëshmi të së kaluarës. Një nga zonat më të thella malore të Shqipërisë është Dukagjini. Në këtë territor ka shumë dëshmi historike.

Kjo zonë është shumë e vjetër në histori. Këtu akoma “shungullojnë” legjendat për Orë e Zana, gjallojnë këngët e vajet, ka kështjella mjaft të vjetra, ka vendbanime të vërtetuara që zënë fill shumë herët në histori, ka male e luginë që bartin mbi vete histori të thella dhe pasuri të mëdha, ka kisha shumë të hershme, ka shumë e shumë vegla pune origjinale dhe të vjetra, ka fjalor mjaft të pasur, ka vegla muzikore, ka këngë e valle shumë të bukura, ka shtëpi banimi unikale, etj.

Në Dukagjin ka tri kështjella, minimalisht mesjetare, po folur dhe për shumë vende që në të folurën vendase quhen “qytetëza” të cilat mundet që flasin për të kaluarën edhe këto, në Theth ka vendbanim rreth 3000 vjeçare, ka kisha që zënë fill shumë herët në mesjetë, por mungon interesimi dhe konservimi i tyre. Brenda tyre ka histori që “flenë” por nga dita në ditë po “vdesin” fare. Mbi to nuk mungon edhe dora keqbërëse e njerëzve mendjeshkurtër dhe që nuk dinë vlerat e tyre. Me lëvizjen e popullsisë po harrohen edhe doke e zakone shumë të mira, po humbasin në rrjedhën e civilizimit e që “ruli” i globalizimit vepron fuqishëm, për të cilën brezat e ardhshëm do të na “kërkojnë” llogari sepse do të kërkojnë rrënjët e tyre, pavarësisht se ku punojnë dhe jetojnë, pavarësisht se norma dhe tradita të reja po hyjnë dhe do të hyjnë, por ato tregojnë rrugën nga kemi ardhur.

Por çfarë po ndodhë konkretisht me gjithë këtë pasuri të vyer. Këto vlera, ato që kanë mbetur, po “vdesin” çdo ditë nga shumë faktor, po shkatërrohen nga koha, por edhe nga pakujdesia ndaj tyre.

Historia, arkeologjia, etnografia, kultura, etj. nuk janë vetëm në qytet. Ato janë, me shumicë, në fshatra, qofshin fushore apo malore. Është shumë bukur kur ka monumente të historisë dhe kulturës në zona malore. Atje, në Bjeshkët e Dukagjinit “flasin” me zërin e tyre të mundshëm kështjella, vendanime shumë të vjetra, ura interesante, rrugë e qafa në lartësi malore rreth 2000 m mbi nivelin e detit që dora e malësorit ka punuar në to në shekuj për të bërë të kalueshme. Shteti duhet të ndërhyjë. Nuk ka sesi të mos e tërheqë vëmendjen e shtetit gjithë kjo pasuri që po “vdes”. Riorganizimi territorial krijon mundësi të shumta për ndërhyrje me studime, restaurime dhe publikime për këto objekte të historisë dhe kulturës tonë kombëtare. Shteti, Ministria e Kulturës, Bashkia duhet të bëjnë projekte të veçanta për hulumtimin e tyre, me qëllim që të vihen në dispozicion të kohës, në dispozicion të komunitetit, në dispozicion të gjithë atyre turistëve që vizitojnë këto zona nga gjithë anët e botës, objekte, këto, që do të tërheqin edhe më shumë turistë.

Janë vlera të identitetit tonë që duhet ruajtur, janë vlera të pazëvendësueshme, është ekzistenca e qenies tonë. Duhet bërë diçka që të ruajmë vetveten dhe ty tregojmë brezave që vinë se kush kemi qenë që të dimë ata se kush janë e nga vinë. Ruajtja e kulturës dhe traditave të mirë është domosdoshmëri, për sot por bëhemi më të qëndrueshëm edhe në të ardhmen.

Vërtetë riorganizimi territorial krijon mundësi shumë të mëdha, por duhet vlerësim, planifikim, vullnet, këmbëngulje, guxim, bashkëpunim, organizim dhe menaxhim problemesh dhe fondesh. Është koha të kujdesemi sot, sa më parë, që të mos thuhet më vonë “na ishte një herë”. “Kushtrimi” i këtyre monumenteve që po “vdesin” duhet dëgjuar më mendje dhe me zemër. Janë vlera që kanë krijuar brezat e kaluar, por u duhen brezave që vinë.

Janë shumë punë dhe në shumë drejtime por për këto që u shkruan këtu janë “thirrjet” e “fundit”, prandaj janë me ngut të madh sepse janë në “buzë të varrit”.

Luigi SHYTI

PARADOKSE TË QYTETIT TIM

FLAMUJT E GASPER TRAGAÇIT

“Very silly are albanian!”. Kjo ishte shprehja e një çifti anglez, që me sa duket kishin ardhur si turistë në Shkoder, tek po kalonin afer ish Pesë Heronjëve. E përkthyer në shqip do të thotë: Shumë budallenjë janë shqiptarët! E gjitha kjo falë vetëm hatasë që po shikonin nga prania e mijra e mijra flamujve të të gjitha ngjyrave që përfaqësonin gjithë spektrin politik të vendit tonë. Sa shumë flamuj! Sa shumë parti! Sa shumë ...! Sa shumë...! E ne... sa pak! Sa pak! Shkoda nën hijen e flamujve. Rrugë që u ngajnë tunelave të errëta. Pushtet absurd i ngjyrave. Dhunë e mirëfilltë psikologjike. Tundim e depresion. Ç’akord marramendës! Disproporcion. Disharmoni! Ç’ekuilibër. Poetikë humorizmi e denjë për stilin Pirandelian! E vetmja anë positive për lypsarët, që të pakten gjejnë një hije poshtë flamujve për



të shtrirë bezen e ndyrë mbi të cilën qindarkat e hedhura nga ndonjë bamirës kalimtar, zhurmojnë si tinguj funerali të kobshëm. Por jo vetem kaq. Edhe burri i djersitur nga dielli përvëlak ndjek hijen e flamujve dhe thërret ritualin e përditshëm :Hajde çaj mali , vetem pesedhjetë lek tuba! Ndërsa një urim e bën edhe për flamujt : Shyqyr Zotit që u çuen ka flamuj se gati ma pat plasë dielli kryet! A thue i lanë shumë pa i hjekë? Se sa për të tjerat drejt i martë te tanë! I pagucun në shpirtë nga domethënia e flamujve ndjek zigzakun e hijes se tyre deri në perendim të diellit. Ndërsa mua mu kujtua Gaspr... Gasper Tragaçi, ai personazhi i famshëm i Koliqit tek libri “Tregtar flamujsh”. Ai Gaspr që e “pom-ponte” intelektualin Hilush Vilza që të shkruante sa më shumë për flamurin shqiptar...dhe e gjitha kjo vetem e vetem që të nxirrte flamujt e tij të mbetur stok në magazinë e t`i shiteshin, se sa për patriotizëm nuk i plaste fare! Këta tonët, e kohës së sotme, bëj be se e kanë vetëm për patriotizëm e dashuri ndaj Atdheut! Hajri kjoftë! Sa shumë pasardhës paska pasë ky Gasper Tragaçi! Po ku drejtin e gjete more Koliq këtë palo njeri që la kaq shumë trashigimtarë?!

BREZI I “KRISTALTË” I NJERËZVE TË KRISTALIT

Sa herë në jetën tonë u jemi drejtuar njerëzve të mirë me shprehjen:Ti je i kristaltë more vëlla! Por erdhi një ditë e një kohë kur emrat simbol të virtyteve njerëzore u damkosen mbi fasada muresh brenda së cilave goja lulëzon dituria e virtyti njerëzor. Ia fil-luan nga emrat e metaleve të çmuara e deri tek dukuritë natyrore që i kanë sjellë njerëzimit begatinë ndër shekujt e historisë së tij. Çuditërisht quheshin

UNIVERSITETE! U dynden brenda mureve të tyre “elita” intelektuale, të cilët ndonëse kishin konkuruar disa herë dhe nuk kishin fituar të drejta studimi, më në fund e gjetën strehën në këto kthina me emra tërheqës e zorrë të kalbura. Ç’programe që kishin more i dashur lexues! Mjaftonte të shkojë në orën 8.00 dhe të diplomohesh në orën 10.00 të të njëjtës ditë! Ju

ndoshta nuk e quani arrirje. Gaboheni. Pasha Zotin gaboheni! A nuk i shikoni këta pinjollë e pinjolle tek bëjnë karrierë? Krekosen, Pispillosen, Filozofojnë! Mbahen rëndë , rëndë! Të aftë për përthyer karakterin e tyre. Imitojnë steriotipe dinamike të ndryshem brenda së njëjtës ditë. Shkallën e delitantzimit e kanë ngritur deri në qiell. Nga duart e ture po gatuhet një brez. Një brez që nesër do të do të marrin fatin e ketij vendi në dorë. Gatuhet nga njerëzit e “Kristalit”, por nuk do të jenë të tillë në jetë. Ata dhe ato po gatuhet si qelqurina.Nesër do të thyhen në rrugë. Njerëzve do t`u theren këmbët. Do rrëzohen e do t`u theren duart. Do të rrëzohen e do të çahen në fytyrë. E në fund të fundit njerëzit e bëjnë kombin. E po mbeti kombi pa fytyrë...larg qoftë! Atëherë ne nuk na mbetet gjë tjetër, veçse t`ua “rrisim nderin” njerëzve të “Kristalit” për shërbimin që i bënë Atdheut tonë, pasi ata vetë nuk e njohin këtë koncept.

A ËSHTË SHKODRA “GOJA E KALIT”

Qindra studiues e kritikë të letërsisë , si nga Evropa ashtu edhe nga Amerika e më gjerë, kanë thënë mendimin e tyre për domethënie e titullit të romanit “GOJA E KALIT” e shkrimtarit anglez Xhojs Keri. Maja e mendimit kritik rreh në versionin, se në një shoqëri kapitaliste, ku stomaku i materialitetit ka turr çdo gjë që ka të bëjë me idetë dhe artin, intelektualit përtypet nga shoqëria dhe shteti njëllëj si ush-

qimi në gojën e një kali. Shkoda jonë ka historikisht një identifikim pozitiv me shprehjen :Shkoda është djepi i kulturës! Sa shpesh e përmendim këtë shprehje, ndonjëherë vend e pa vend. Dhe nga të gjitha shtresat ajo që e përdor më shpesh është ajo që nuk ka shkelur as në portë dhe as në dritaren e ngrehinës së kultuës së këtij qyteti.Këtë shprehje përpiqen ta perdorin si vello fallco edhe në ato raste kur realiteti të zhgënjn deri në palcën e vetëdijes. Por ky qytet ka edhe epitete aq negative saqë i permendim vetëm vesh më vesh dhe madje shtojmë edhe një shprehje me vlerën e një pjesëze përforcuese :Nuk i knë thanë kot Shkodër k...a! A nuk është e rrezikuar kjo kulturë sot ? Unë mendoj se jo vetem kaq, por është edhe e goditur rëndë. Po kalon në një fazë dekadence e rënie picingul. A është tronditës kur dëgjon në këtë fushatë elektorale shprehje të tilla:Do ta kthej Shkodrën në identitet; do ua kthej Shkodrë shkodoranve! Brendia e domethënies të jep për të kuptuar se Shkoda e ka humbur identitetin dhe nuk ka mbetur më e shkodoranve. Ku janë intelektualët shkodoranë? Përse heshtin ata? Kush do t`i përfaqësoje në këshillin e kësaj bashkie të stermadhe? Heshtja e tyre ka për ta vlarë këtë qytet, ashtu siç po e vret dita –ditës. Ambientimi me të keqen do ta sjellë” Rinocerontin” e Joneskos mu në mes të këtij qyteti. Ai po na shtyp e do të na shtypë edhe më tepër. Pse duhet ta pranojmë këtë poshtërim. Pse duhet ta pranojmë këtë “Gojë kali” që po përtyp çdo gjë të mirë e intelektuale? Atëherë atyre, intelektualëve, nuk do t`u mbetet gjë tjetër veçse të kujtijnë shprehjen e Bodlerit :TË DUA O QYTETI IM I NDIYRË!

LAZER KODRA

Një ditë në shkollën 9 vjeçare Bardhaj

Jo gjithnjë ndryshimet e drejtuesve të shkollave e japin pritshmërinë, sepse shumëherë dominon militantizmi e jo meritokracia. Në shkollën 9 vjeçare Bardhaj ka ndodhë krejt e kundërta. Ka një vit që drejtimi i kësaj shkolle i është besuar të palodhurës, autoritares dhe profesionistes znj. Tereze Brigja. Falë vitalitetit e perkushtimit të saj për ta justifikuar besimin e dhënë, sot shkolla 9 vjeçare Bardhaj ndryshon si nata me ditën krahasuar me një vit më parë, duke filluar që nga krijimi i kushteve të përshtatshme për mësim, eliminimi i çdo të keqeje që vjen nga jashtë, rritja e mobilizimit të kolektivit mësimdhënës duke çuar në vend autoritetin e mësuesit, që në shumë shkolla është shumë i nëpërkëmbur. Ka rritë bashkëpunimin me komunitetin, pushtetin vendor, organet e arsimit, organizatat joqeveritare, institucionet e kultit, shtue veprimtaritë artistike e sportive e të tjera. Të gjitha këto kanë bërë që të kenë shumë progress procesi mësimor – edukativ e shkolla e Bardhajve të jetë sot në pararojë të shkollave jovetëm në komunën Rrethina, por edhe më gjërë.

Shtysë për të shkruar këta rrjeshta, për këtë shkollë u bë një veprimtari që ajo zhvilloj në ambientet e saj, me temë: "STOP GJAKMARRJES, PROJETËS".

Ky aktivitet kishte shumë anë positive, si angazhimi maksimal i kolektivit mësues – nxënës për realizimin e tij, me problematikat që mbarte, nxitje forcën krijuese të nxënësve në letërsi e pikturë, rritje bashkëpunimin me shoqatën "Eorld Vision" dhe kishën, duke rritë tek nxënësit forcën edukuese dhe bërë që ata të kenë vizione të qartë bashkëkohor duke luftuar që në embrion ato mentalitete që i përkasin të kaluarës, siç është gjakmarrja. Është e vërtetë se ndër shumë plagë që tranzicioni solli, më tragjikja ishte gjakmarrja, me të cilin ndër fshatrat më të prekura, ka qënë fshati Bardhaj.

Është pozitiv fakti, që kjo dukuri ka ardhë duke u minimizuar dhe është për të ardhur keq që shoqatat japin shifra të fryra e joreale për të justifikuar shpenzimet, që ato bëjnë në kuadër të luftës kundër këtij fenomeni. Sigurisht, që gjakmarrja nuk është zhduk dhe çfarëdo që të bëjmë

që të sherohemi nga kjo plagë, ne nuk bëjmë sa duhet. Këtë qëllim kishte edhe veprimtaria që u bë në ambientet e shkollës 9 vjeçare Bardhaj, që për nga organizimi, cilësia interpretuese ishte për t'u pasur zili nga shkollat më prestigjioze të Shkodrës. Këtë aktivitet e hapi zv/ drejtori i shkollës z. Lekë Pjetri, Ai, që ka një kontribut të madh në konsolidimin e arsimit në Bardhaj në dekadat e fundit, i cili ndër të tjera falënderoj të ftuarit

për forcën krijuese dhe cilësinë interpretuese, që nuk di të veçosh më parë. Nxënësit e kësaj shkolle janë vlerësuar me çmime edhe në veprimtaritë e ndryshme që janë organizuar në shkollë qarku.

Ishin harmonizuar mjaft mirë kënetat solo me ato në grup, të cilat shoqëroheshin në fizarmonikë nga mësuesi Arbeni, i kalonin përmasat e një shkolle fshati për vokalin e cilësinë interpretuese të nxënësve: Kristina

mjeshtërisht nga grupi i mësuesve të shkollës, duke dhënë një shembull që duhet përgjithësuar se, mësues – nxënës duhet të jenë një e të pandarë duke rritur kështu autoritetin e mësuesit.

Në këtë shkollë punohet në të tërë kompleksitetin e detyrave që ajo ka. Rezultatet janë të prekshme. Na gëzon fakti që në procesin mësimor mbi 80% e të dalluarve në asimilimin e dijeve shkencore janë me origjinë dukagjinase duke e ruajt traditën si inteligjent dhe arsimdashës.

Duke parë këndet e klasave apo të shkollës na bien në sy si të dalluar mbiemrat: Bregu, Toma, Ballza, Shkrepa, Shpati, Preka, Pepa, Shpella, Kola, Koster, Aroni, Rrasa, Martini, Bleta, Ndou e të tjere mbiemra, të cilët i kemi takuar edhe në zonat malore ku kemi pasur fatin të shërbejmë.

Drejtorja e shkollës ka plane afatmesëm e afatgjatë për ta konsoliduar akoma më shumë gjithë procesin mësimor – edukativ. Drejtoresha, duke pas vizione bashkëkohore për arsimin,

është e kënaqur me arritjet, të cilat kanë pasur shumë progres në vitet e fundit, por është e ndërgjegjshme se duhet bërë shumë më tepër në të ardhmen, duke e përqëndruar punën më tepër në problemet e përmbytjes, sepse ka ende shumë nxënës që kanë mjaft mangësi në përvetësimin e njohurive shkencore, duke rrezikuar që disa të kthehen në analfabet të "heshtur". Prandaj është e nevojshme që mësuesi të jetë më afër nxënësve, të njohë sa më mirë veçoritë psikologjike, interesat, vizione e talentin e tyre. Njohja e karakteristikave të nxënësve, e individualitetit të secilit e vendos mësuesin në pozita të tjera mësimdhënje larg metodave tradicionale shablone. Kjo e parapërgatit atë për të ndërtuar planin ditor dhe punën për anën shkencore të shpjegimit dhe vendosjen e ekulibrave intelektual e shpirtëror në orën e mësimin në mënyrë, që ajo të ketë rendiment sa më të lartë dhe çdo nxënës të dalin më i ditur në përfundim të saj. Përgatitja e mësimin nuk fillon e mbaron me ditarin, i cili fatkeqësisht shumë herë bëhet skematik e formal, por duhet të jenë funksional në përputhje me nivelin e nxënësve dhe mësuesi t'i japin jetë në orën e mësimin.

Mësuesi, krahas vënies së çdo nxënësi në situatë pune, duhet të jetë një artist në komunikim me ta, duke mos bërë ndarje në klasë, duke mos heqë dorë nga asnjë nxënës e aq më tepër nuk duhet të kenë asnjë shprehje ofenduese e denigruese ndaj nxënësve, të cilët nuk kanë ecuri të mire, sepse frenojnë të nxënët nga ata, krijojnë një gjendje mosbesuese dhe humbje besimi në vetvete. Sa më i përkushtuar, që mësuesi të jetë në orën e mësimin, sa më tepër të përdori metoda bashkëkohore për mësim duke e konsideruar nxënësin objekt e subjekt i mësimin, aq më të larta do të jenë rezultatet e më të vogla mangësitë. Shembulli pozitiv egziston, por ai duhet përgjithësuar akoma më mire, sidomos nëpërmjet kualifikimit të mbrendshëm. Mësuesi e prindi duhet të punojnë në të njëjtën frekuencë, për edukimin dhe mirëmbesimin e fëmijës. Kjo arrihet duke rritë cilësinë e pedagogjikisht bashkëpunimin midis tyre. Ndikim pozitiv në arrijtjet që kjo shkollë ka, sidomos në vitin e fundit ka pasur bashkëpunim shumë të mirë me pushtetin vendor, i cili edhe pse nuk e ka marrë asnjëherë në dorëzim godinën e kësaj shkolle nga firma ndërtuese, falë edhe insistimit të drejtorisë së shkollës, ka kontinuar në mënyrë të mjaftueshme për përmirësimin e infrastrukturës, sistemin e ngrohjes dhe paisjen me materiale konsumi. Bashkëpunim shumë të mirë kanë patur me DAR Shkodër, që kjo e fundit nuk e ka kursyer ndihmesën për shkollën në fjalë. Ky bashkëpunim nuk do t'i kishte këto nivele nëse, në krye të këtyre dy institucioneve nuk do të ishin këto dy zonja të nderuara. Bashkëpunim frutëdhënës kjo shkollë ka edhe me shoqatën "World vision", e cila nuk e ka kursyer ndihmesën në përmirësimin e infrastrukturës, gjelbërimin dhe sidomos në problemet e edukimit.

Në sajë të punës së bërë nga kolektivi mësimdhënës i kësaj shkolle, vitin shkollor 2014-2015 po e mbyllin me rezultate më të larta se asnjë vit tjetër. Këto përbëjnë një bazë të shëndoshë për arritje më të mëdha në të ardhmen, kurse të metat dhe mangësitë e vrejtura do të bëhen mësim për të rritur akoma më shumë mobilizimin për eliminimin e tyre në mënyrë që vitin e ri shkollor ta fillojnë e vazhdojnë me energji të reja.

Pergatite nga
PRELË SHYTANI



pjesmarrës që ishin të shumtë si nga MASH, DAR Shkodër, pushteti vendor, shoqata të ndryshme joqeveritare, komuniteti i prindërve, drejtues shkollash e mësues, drejtues institucioneve e të tjere.

Mbi tematikat dhe ecurinë e aktiviteteve referoj psikologu i shkollës, Arvjo Fishta, i cili ka meritën kryesore në organizimin e kësaj veprimtarie ku me punën e tij të palodhur e profesionale, mbylli gojë të shumë skeptikëve, të cilët kishin rezerva për rolin e psikologut në shkollë. Kishte bërë një javë veprimtari me tematika të ndryshme, për çdo ditë dhe kulmoj me ditën për të cilën po bëjmë fjalë. Ai kishte bërë edhe një punë studimore e shkencore duke nxjerrë rezultate konkrete mbas plotësimit të shumë pyetësorëve nga ana e nxënësve dhe mbi bazën e këtij studimi do të hartohet puna në të ardhmen në bashkëpunim edhe me mësuesit kujdestar. Do të ishte mirësi e shumë frutëdhënëse, që çdo shkollë ta kishte një psikolog si ky.

Për cilësinë e koncertit meritë të veçantë kanë: mësuesi i apasionuar i edukimit muzikor z. Arben Jubani dhe mësuesja e letërsisë zonj. Mira Pjetri, të cilët, me punën e tyre, kanë bërë që shumë nxënës të shquhen

Shpati me këngën "Do të bëhem poliglote", Aldi Verri, me "Këngë popullore zgjedha këngën", Elidona Preka, me "Shumë urime për ty", Arsila Isufi me këngën "Përtaci" si dhe kënetat perla të muzikës së lehtë shqiptare "Rrjedh në këngë e ligjërime" dhe "E dua lumturinë", interpretuar respektivisht nga Mariza Froku dhe Emanuela Neçaj.

Të gjitha poezitë ishin krijime të vetë nxënësve që trajtonin kryesisht temën e gjakmarrjes, që na emocionuan me interpretimet e tyre: Sara Kodra, Rina Rrasa, Emanuela Camaj, Marilda Ndoja, Aida Aroni, Aleksandër Rrasa dhe sidomos Marsela Bregu, me krijimin dhe interpretimin e saj me poezinë "Mjaft gjakmarrje", e cila na bëri të kujtojmë dramën e saj familjare.

Gjallëri kësaj veprimtarie i dhanë vallet e interpretuara plot gjallëri nga grupi djem – vajza, që binte në sy edhe kostumografia e zonave e krahinave nga kanë ardhë. Mbresëlënëse për nga interpretimi dhe tema që trajtonte ishte drama "Stop gjakmarrjes, pro paqes", krijuar nga vetë nxënësit. Kjo veprimtari artistike u mbyll në mënyrë më të mirë të mundshme me një kolazh këngësh popullore qytetare, interpretuar

ZEF MALA, MES LAVDISË DHE PERSEKUTIMIT

100 VJETORI I LINDJES (14 PRILL, 1915-2015)

“MERITAT DHE MBROJTJEN TIME IA KAM BESUE HISTORISË SË NESËRME” ...

Kristalizimi i ideologjisë shqiptare .. “Po kërkem Zotin e gjejmë në “Njerzënë” po kërkem idealin e gjejmë në “Dashurinë”. Pra të kërkojmë me dashhtë atdheun tonë, të bukurën Shqipni e frymëzimi i kësaj Zoje të shenjtë ka me na ba dashunorë për mbarë njerzimin e për mbarë botën. Të heqim paragjykimet, ambicjet e egoizmat që na kufizojnë... Të përqafojmë sa ma shumë mundemi. S’ka Zot tjetër përveç dashunisë, s’ka Dashuri tjetër përveç asaj të Njerzisë e s’ka Njerzi pa Atdhe”. Botue ne vitin 1934

Për rininë “Në rininë tonë shifet një plogështi që të merr frymën. E kalon motin tue u endë rrugash ose tue ndejtë ndër vende dëfrimi, kurse i duhet me u ndry mbrenda tue mendue se si kishte mund me i zgjidhë në mënyrë të dobishme çështjet që i përkasin jetës së përbashkët. Nuk kemi kohë me u tallë”. Botue në vitin 1934

Për politikën “Në Shqipni, ka pasun kurdoherë grupe dhe parti politike në kundërshtim me programet, në qëllimet, në shujtat dhe në interesat. Edhe pse në të shumtën e herëve luftimi nuk ka qenë e mundum të bahet çiltaz, secili grup asht përpjekë nën dhe, me i ba vorrin tjetrit, e triumfue mbi të”. Botue në vitin 1935

DATA DHE NGJARJE KRYESORE NË JETËN DHE VEPRIMTARINË E ZEF MALËS

Zef Mala, ka lindë me 14 Prill 1915, prindët e tij ishin Gjoni dhe Shaqja. Gjyshi i tij (nga ka marrë dhe mbiemrin) ka qenë Mal Jaku, i njohur në kahunë e Pultit si i pari i fisit “Pepaj”, patriot e luftëtar në mbrojtje të trojeve amtare. Vendlindja e Zefit, shkruhet Shkodër, ndërkohe që sipas gojdhënave; thuhet se ai ka lindur dhe jetuar deri në moshën 4 vjecare në lagjen Mahallë në fshatin Plan të Dukagjinit. Gjoni i ati, në kërkim të një jete më të mirë dhe për të shkolluar femijtë u shpëngul për në qytetin e Shkodrës nderkohe që dhe bashkeshortja i vdiq, keshtu Zefi që i vogël mbeti jetim.

Në vitin 1933, mbaron “Kolegjin save-riane” të Urdhërit Jezuit në Shkodër me rezultate shkelqyeshem (nota10).

Ne vitin 1934, vendoset të jetojë në Tiranë, publikon në gazetën “Besa” artikuj tematik mbi shoqëritë rinore dhe shkruan në rubrikën “Jetë shkrimtarësh të mëdhej”. Shfaq mendime letrare për shkrimtarët italo-arbëreshë e bashkëkohorë si: E. Koliqi, E.Haxhiademi, etj.

Në vitin 1934, fiton një bursë shtetërore nga qeveria e Zogut për studime në Universitetin e Vienës në Fakultetin e Filozofisë. Aty ai, bie në kontakt me teoritë e së majtës Evropine.

Në vitin 1935, boton revistën social-politike “Fryma e re” në Shkodër, ndalohet që në numrin e parë. Në vitet 1935-1937, punon dhe si redaktor në gazetën “Arbënia” në Tiranë, bashkëpunon me revistat; “Minerva”, “ABC...”

Në vitin 1936 pas dy vite studimesh, kthehet në Shkodër pasi i ndërpritet bur-sa nga Qeveria e Zogut.

Në vitin 1937, themelon grupin komunist të Shkodrës me ndihmesën e Vasil Shantos, Gjovalin Lukës, Niko Xoxit, Tuk Jakovës, Qemal Stafës, etj. Boton materiale propagandistike komuniste e analiza sociale për Shqipërinë. Kritikon sistemin monarkist dhe kërkon organizimin sindikal kundër regjimit të Zogut. Kërkon përfaqësimin e krahut të majtë në parlamentin shqiptar.

Dhjetor 1938, boton organin politik të grupit komunist të Shkodrës “Buletini jeshil”.

Janar 1939, “Buletini jeshil” arrin në numrin 3 dhe mbyllet. Zbulohet veprimtaria kundër rregjimit, arrestohet Zefi me gjithë anëtarët e grupit dhe kallëzohet në hetuesi, i sekuestrohen materialet propagandistike e mjetet e shtypit.

Me 11 Shkurt 1939 del në gjyqin e hapur që zhvillohet në Bashkinë e Tiranës. Zef Mala dënohet me 10 vjet burg, me akuzën: “krijimin e një organizate komuniste e thirrje për rrëzim me dhunë të sistemit kushtetues”. Në këtë “Gjyq Politik për propagandë Komuniste” mbi 70veta kryesisht të rinj akuzohen për lidhjet me Zef Malën. Fillon vuajtje e dënimit në Mbreshtan të Beratit. Cfare thuhet ne historine e PKSË per kete gjyq dhe per Zef Malën janë të paverteta, të qellimshme për denigrimin e tij.

Me 6 Prill 1939, bashkë me Vasil Shanton dhe të burgosur të tjerë shpërthejnë burgun e nisen që të organizojnë mbrojtjen nga pushtimi fashist në Durrës, nderkohe mbreti Zog që arratisur nga Shqipëria. Ishte teper vonë, me 7 prill fashistet italiane kishin zbritur dhe tashme kishin pushtuar Shqipërinë. Ai me shoket ndërroj rrugë e u arratis ne Jugosllavi, ku nuk u pranuan si azilant politik prandaj u kthyen menjehere.

Në korrik të vitit 1939 “Për meritë të Zef Malës- u krijua Partia Komuniste Shqiptare” kujton Kasem Trebeshina. Ai jo më shumë se 24 vjec, me mencuri e tolerance, mundi te forcojë organizatën, por dhe bashkojë bile dhe njerez me pikepamje shumë të kunderta, të vendose lidhje me partite e majat italiane. Kjo parti nga E.Hoxha është quajtur si Partia socialdemokrate e Zef Males.

Në nëndor 1939, kapet nga fashistet si organizator i demonstratave dhe internohet për 5 vjet në ishullin famëkeq “Ven-

totene” në kampin e Santo Stefano-s në Itali. Vuan dënimin në shoqërinë e personaliteteve politikë të rezistencës antifashiste italiane, të majtë e demokristianë të De Gasperit; - Sandro Pertini (president i Italisë), Luigi Longo, Pietro Neni, etj. Ne këto vite ai thellon studimet tashmë jo vetëm për filozofi, por dhe për letërsi e arte, për ekonomi e jurisprudencë. Ai tashmë zotronte mjaft mirë gjuhët e huja si: gjermanisht, frangjisht, anglisht, italisht, greqisht dhe latinisht. Përseri ruan kontaktet me “Grupin e Shkodrës”, mbledh ndihma për të, me anë të P.K. Italiane në Bolonja.

Në verën e vitit 1943, e kthejnë nga internim në Tiranë për t’u rigjykuar. Gjykatat e denon perseri me 15 vjet burgim. Ai mundi të arratiset nga burgu i Tiranës me disa komunistë e të tjerë. Mundi të qëndronte i fshehur në Tiranë tek dajat e tij (Luigj, Filip, e Shuk Shukaj). Pas disa ditësh ai me kërkësë të Enverit shkon në batalionin e dytë të Grupit të Pezës ku ndodhej dhe Meladin Popoviçi..”

Në verën e vitit 1944-në një takim në Pezë me Enver Hoxha e Miladin Popoviçin pyetet nga Miladini për qëndrimin që duhej mbajtur nga komunistët pas luftës ndaj Kosovës. Zefi shprehet në takimin me “Çështjen e Kosovës do ta zgjidhë populli me zhvillimin e një plebishiti, pas luftës”.

Me 4 prill 1944, E. Hoxha urdhëron -shokun Nako (Spiru) - “Zef Mala të mos shkojë në Kosovë. Përkundrazi ta dekoroni me një plumb kresë. Ai s’është i mirë dhe duhet të zhduket.

Në vitin 1945-shkon në Itali për të operuar sytë. Nga studimet, shkrimet e përkthimet e shumta shikimi ishte pakësuar mjaft. Rivedos kontakte me miqtë antifashistë, tashmë aktivë në politikën italiane. Ju krijuan dhe ju afruan mundësitë për të qëndruar në Itali, por ai nuk pranoi. Ndër kohë ju dhe një munde-

si për të mbajtur një fjalim në Piacenza - Romë, në “Mbrojtje të çamëve që masakroheshin nga grekët”, fjalim që pati jehonë në shtypin italian.

Në vitin 1946, pas kthimit në Shqipëri, kur punonte në bibliotekën kombëtare, arrestohet papritur, dënohet me 10 vjet burg. Motivi i dënimit; “Për qëndrimet politike kundër bashkëpunimit me partinë komuniste jugosllave”. Kryen 2 vjet denim e lirohet me 19 janar të vitit 1949 përmes amnistisë nga ndryshimi i

qendrimin dhe bashkëpunimit me Jugosllavinë, si viktimë e Koci Xoxes.

Me urdhëresën e Kryeministrit nr. 21 datë 8.6.1949, krijohet Arkivi i Shtetit. Ky institucion e kishte vartësinë nga Kryeministria, drejtor u emërua Zef Mala, si themeluesi kryesor, si personalitet me kulturë e vizion, si njeri erudit e njohës i disa gjuhëve të huja. Në këtë detyrë, ai punon me pasion dhe profesionalizem. Grumbullon fondet arkivorë të shpërndarë e të shkatërruar në gjithë Shqipërinë, bën kodifikimin sipas sistemit austriak. Ai bashkëpunoj me specialistët në arkiv; Injac Zamputti-latinisht, Sotir Papahristo-greqisht, Jonuz Tafilaj-turqisht. Zef Mala merrej vete me dokumentet gjermanisht-anglisht, ai krijoi fondet arkivore të Lumo Skëndos, Mirash Ivanajt, Mehdi Frashërit, Mustafa Krujës, Fishtës, Luogo Tenenza-s-’Jakomonit’, Lef Nosit dhe të gjithë ministrave që u qenë konfiskuar arkivat. Gjithashtu arkivoi kodikët e regjistrat e kishave të Elbasanit Tiranës dhe shkresat zyrtare të Bashkisë të shkruara turqisht etj. Bashkëpunoi ngusht me Aleks Budën që aso kohe ishte shefi i seksionit të Historisë në Institutin e Shkencave. Zef Mala për pasurimin Arkivit te Shtetit, nisi të blejë materiale të ndryshme me vlera te medha nga antikuaristët privatë si: Jashar Erebara, Teki Selenica.

Në vitin 1950-përgatit një dispencë historie për Institutin Pedagogjik “Mbi Shqipërinë e viteve 1912-1924”, (e konfiskuar dhe e humbur).

Në vitin 1950, martohet me Aferdita Shahinin, nga kjo martesë i lindin dy vajza, Maria dhe Esmeralda. Aferdita Shaini ishte shkolluar per mjeke në Francë. Ajo kishte marre pjese ne luften NÇL. Ja cfare kujton per Aferditen shkrimtari I madh Petro Marko “Me kujtohen vitet tridh-jete: kisha vajtur ne Korce per te bere nje ankete per gazeten “Vatra”, ku punoja. Kisha njohur Viti Shahinin (Aferdita), nje shoqe shume e mire qe studionte ne France, ku pati njohur Halim Xheloni, i cili i jepte materiale per mua. (Ajo me vone u martua me mikun tim te dashur Zef Mala, njeri shume i kulturuar, themelues i grupit komunist te Shkodres qe me 1937) Njoha dhe vellane e saj Ilo Shahinin, te cilit i mesova te kendonte “Internacionalen”. Plaku Vangjel, i ati i Vitit dhe i llos, pyeti se c’ ishte kjo kenge. Ia shpjeguam dhe ai menjehere thirri: “Aman, mos e mesoni, se kur te shkoni ne Tirane, ne hotel, mund ta kendoni ne gjume e pastaj na merr lumi! Ja cfrike na kishte hyre ne palce”.

Në vitin 1955, arrestohet e dënohet me 5 vjet burg motivacioni “I dyshuar për lidhje me eksponentë të së majtës në perëndim”.

Në vitin 1958, një delegacion italian dërguar nga L. Longo i kërkon Enver Hoxhes, lirimin e Zefit nga burgu, lejimin e tij për të shkruar në Itali. Kërkesa nuk u realizua.

Në vitet 1961- 1964, interno-



DEKLARATE E UNIONIT TE GAZETAREVE SHQIPTARE – DEGA SHKODËR, ME

RASTIN E 3 MAJIT, DITES BOTERORE TE LIRISE SE SHTYPIT

Të nderuar miq dhe kolegë gazetarë, anëtarë të Degës Rajonale të Shkodrës pranë Unionit të Gazetarëve Shqiptarë (UGSH)

na krijuar një opinion shumë pozitiv për gazetarinë në Shkodër.”

Konstatimi i mësipërm na con 17 vjet prapa tek një pohim i Drejtorit të Institutit

potencë atëherë do ta ketë për detyrë që të na ndihmojë ne të gjithë ve edhe më shumë.

prej 500 personash do t'i servijë publikut si nje miting me 50 mijë vetë. Pra për të shmangur këtë lojë qesharake gazetarët janë të lutur që të shkojnë vetë direkt

Nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara dita e 3 Majit është shpallur Dita Botërore e Lirisë së Shtypit për të ngritur vetëdijen dhe rëndësinë e lirisë së shtypit si dhe për t'ua kujtuar qeverive detyrën që kanë në drejtim të respektimit të së drejtës së shprehjes së lirë që është e garantuar me nenin 19 të Deklaratës së Përgjithshme të Drejtave të Njeriut.

Dega Rajonale e Shkodrës e krijuar qysh në vitin 2007, si një ndër degët e para dhe më aktive të Unionit të Gazetarëve Shqiptarë përkujton sot këtë datë mjaft domethënëse për gazetarët në të gjithë kontinentet.

Viti 2014 ishte nje vit i suksesshem për Degën e Unionit të Gazetarëve Shqiptarë në Shkodër, edhe për faktin se, në ndryshim me vitet e tjera preferuam që të ndërrojm taktikë. Ose thënë ndryshe, dalje më të pakta në media dhe në vend të tyre punë dhe trainime cilësore brenda dhe jashtë vendit. Konkretisht, pas një kërkesë të një organizate tjetër kombëtare mediatike në Tiranë për të trainuar 2 gazetarë nga Qarku i Shkodrës pranë një organizate mjedisore me kërkesën e kësaj të fundit, rekomandova 2 gazetarë, anëtarë të UGSH që i njihni të gjithë. Gjatë vitit 2014 kjo organizatë zhvilloi një projekt të dedikuar tërësisht ndaj rritjes së cilësisë së raportimeve për mjedisin nga media në bashkëpunim me organizatat mjedisore.

Sipas drejtuesve te kesaj organizate pas perfundimit te ketij trainimi në fund të vitit 2014, gjatë një komunikimi që pata me ta: “Dy gazetarët e Shkodrës, kanë pasur një përkushtim dhe sjellje profesionale korrekte duke përfituran nga të gjitha aktivitetet e tij brenda dhe jashtë vendit. Kështu ata u përfshinë në 5 gazetarët më të suksesshëm që në trajnuam. Dashur pa dashur ata kanë ndikuar tek ne duke



të Medias Remzi Lani. Në një tryezë të rrumbullakë t të organizuar me gazetarët e Shkodrës në sallën e Senatit pranë Rektoratit të Universitetit të Shkodrës “Luigj Gurakuqi”, në tetor të vitit 1998 ose një muaj para Referendumit të Kushtetutës, Z. Lani, ndërmjet të tjerash u pat shprehur: “Pas Tiranës, 2 metropolet më të rëndësishme të gazetarisë në Shqipëri janë Shkodra dhe Durrësi.”

Le të shpresojmë pra që të kemi bashkëpunime dhe variante të tjera të ngjashme edhe në të ardhmen e jo vetë m me organizatën në fjalë me qëllim mundësimin e trainimeve edhe për gazetarët e tjerë, brenda dhe jashtë vendit. Kur kemi ne mundësi e ndihmojmë Unionin që të forcohet dhe e kundërta, kur nesë r Unioni do të ketë me shumë

Të nderuar kolegë!

Duke iu rikthyer 3 majit, Ditës Botërore të Lirisë së Shtypit, shfrytëzoj rastin që tu bëj thirrje miqve dhe kolegëve gazetarë, anëtarë të Unionit të Gazetarëve Shqiptarë të Degës Rajonale të Shkodrës që të demonstrojnë një sjellje sa më profesionale dhe të paanshme gjatë ushtrimit të profesionit të tyre fismik në këtë periudhë ku fushata e zgjedhjeve lokale të 21 qershorit sapo ka filluar të nxehet. Konkretisht i bëj thirrje sidomos anëtarëve të Unionit të Gazetarëve Shqiptarë në Shkodër që të evitojnë marrjen e kasetave të gatshme të veprimtarive elektorale të partive politike. Kjo do t'ia humbte vlerën televizionit i cili do të shëndërrohej në një transmetues videoklipesh folklorike ku edhe një grimbullim

e në terren duke raportuar atë c'ka ata shohin direkt e jo gënjeshtër sipas oreksit të partive..

3 majit është shpallur Dita Botërore e Lirisë së Shtypit nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara për të ngritur vetëdijen dhe rëndësinë e lirisë së shtypit dhe për t'ua kujtuar qeverive detyrën që kanë në drejtim të respektimit të së drejtës së shprehjes së lirë që është e garantuar me nenin 19 të Deklaratës së Përgjithshme të Drejtave të Njeriut.

Për Degën Rajonale të Shkodrës së Unionit të Gazetarëve Shqiptarë

Arben LAGRETA
Kryetar

het në Zverec të Vlorës ku gjeti dhe krijoj shoqëri me: K. Trebeshinën, S. Gjakën, gazetarin F. Proko, etj. Aty shkroi një traktat filozofik prej rreth 140 faqe të cilin e mori me vete pas dënimit, ky është zhdukur në rrethana të panjohura.

Në vitin 1965, e thërret në takim kryeministri Mehmet Shehu dhe e paralajmëron: “Po të mos na ngacmohet, as ne nuk do të ngacmojmë më”. Ndonë se jashtë burgut në këtë periudhë, Zef Mala ishte në kontroll, levizje të kufizuara

vetem brenda Tiranës, pra në izolim të plotë fizik e politik.

Në vitin 1977, Enver Hoxha e shikon nga dritarja e K.Q. (sot selia e Kryetarit të Kuvendit) dhe pamja e Zef Malës i duket sfiduese, ai shëtiste si gjithmonë i vetmuar me një nënqeshje filozofike e sytë depërtues nën lentet me skelet të zi. Si hakëmarreës, për armiqësinë e vjeter që kishte Enver Hoxha, dha urdher dhe ai pas tre ditësh u internua për 5 vjet në Labovën e Zhapës-Gjirokastër. Zefi duhet të shkonte në Malin e Gjerë të v

për ndëshkim, ndërsa vetë E.Hoxha të mbetej në kryeqytetin Tiranë- kujtonte I afermi i tij Leci.

Me15 korrik 1978, nga Labova e Zhapës - shkruan një PROMEMORIE emblematike drejtuar Kryeministrit Mehmet Shehu, pasi ai vite me parë kishte nderprerë cdo komunikim me Enver Hoxhën.

Në zgjedhjet e vitit 1978, Zefi nuk pranon të votojë. E arrestojnë e dërgojnë në Tiranë, ku ridenohet me 10 vjet burg. E vuan këtë dënim në burgun e Ballshit ku verbua krejtësisht, ecte me shkop dhe

bashkevuajtesit e ndihmonin për çdo nevojë”- kujton gazetari Foto Proko .

Me 26 dhjetor 1979, Zef Mala i sëmurë rëndë, i verbuar, ndërrohet në natën e vitit të në burgun- spital në Tiranë . Shuhet kështu jeta e një personaliteti të shquar me bindje social-demokrate liberale që gjith jetën ja kushtoj pa lekundje kësaj kauze.

Pergatite nga
Gjon Fierza

FERID FRASHËRI DHE SAKRIFICA TRAGJIKE SI MBROJTËS I AHMET ZOGUT?!

SI E VRAU GJELOSH MARKU FERID FRASHËRIN?!

Ferid Frashëri ishte një oficer karriere i devotshëm, thellësisht i politizuar, i vënë në shërbim të politikës dhe i përfshirë në krahun kombëtar¹. Në gjysmën e parë të viteve njëzet mbante gradën e Kapitenit dhe ka dhënë kontribut të vyer në krijimin e një klime të qëndrueshme politike duke qënë partizan i linjës së grushtit të nokautit. Në ditët e stuhishme, kur ndizej flakë pakënaqësia dhe urrejtja e popullit opozitar, kur Shkodra manifestonte solidaritet me kryengritjen dhe kërkohej hapur zaptimi i zyrave të shtetit dhe përzënia e mbështetësve të Ahmet Zogut, kapiten Ferid Frashëri ishte një mburojë statike e që nuk lëvizte vendit por qëndronte me guxim si Taraboshi mes rrebesheve të motit. Ishte fis i afërm i Melek Frashërit, që kishte lënë kokën me 1922 në Kamzë për Ahmetin, duke u bërë ballë forcave të Elez Isufit gjë të cilën e bëri edhe Feridi në Shkodër dy vite më pas duke thyer rradakën e pabindur në Prefekturë. Ferid Frashëri ka mbështetur Kongresin e Lushnjës dhe qeverinë e dalë prej tij. Qe kobure e mbushur në shërbim të qeverisë në ditët e krizës politike të dhjetorit 1921 dhe në mars të vitit 1922. Kontribuoi në përmbyshjen politike të Tiranës që pat sjellë në pushtet kryeministër Hasan Prishtinën për më pak se një javë. Camillo Libardi në kujtimet e tij historike, e përshkruan si një titan: **"I tillë ishte gjoksi i Kapitenit të xhandarmërisë së Shkodrës, burrë trim, ushtar me kalitje të fortë, shqiptar i vërtetë i bindur se përpara së gjithash duhej të kryente detyrën e tij"**. Në vitin 1924 mbajti detyrën e Komandanti të Qarkut Shkodër dhe punoi energjikisht për shtypjen e revoltës antiqeveritare që ziente dhe e përpui në vorbullën e saj. Opozita në bastionin e saj të mbështetur nga ushtria dhe malësorë u hodh në veprime ushtarake konkrete, por duke parë se Ferid Frashëri ishte pengesë e fortë, i kërkuan të largohej nga Shkodra me kusht që t'i lihej rruga e lirë që të largohej në drejtim të Tiranës. Po ku pyeste Feridi për ultimatumet të tilla, prandaj u dërgoi përgjigje **"Mund të më thyeni por nuk mund të më nënshtroni"**³. Edhe pasi i caktuan kohë për ikjen Feridi as që nuk u tund fare. Atëherë ngjarjet precipituan në mënyrë dramatike. Ndokë Gjeloshi me luftëtarët e tij të Dukagjinit dhanë shenjën e sulmit. Ndërkohë kompania e dytë e batalionit shëtitës e komanduar nga Vas Kiri dhe e treta e komanduar nga Spiro Kosova rrethoi nga pas Prefekturën në strofkën ku qëndronte luani kreshtëkërlëshur. Nga forcat revolucionare, u urdhërua tellalli që i bënte thirrje popullit të Shkodrës se ishte në shtetrrëhim. Kur tellalli shkoi tek prefektura, Komandanti i Xhandarmërisë Ferid Frashëri zbriti nga kati dytë, i nxori

pistoletën dhe desh ta vriste por plumbi e mori në krah, ndërkohë rojet e ushtrisë revolucionare nga pas murit lëshuan një breshëri të dendur drejt Feridit, i cili u fut brenda dhe nuk pati mundësi që ta ndiqte e ta vriste tellallin⁴. Zjarri mes palëve sulmi dhe qëndresa vijoi për gjatë gjithë natës hova-hova. Kur agoi dita dhe sulmuesit po bëheshin gati të sulmonin me granata me benzinë, i bënë thirrje edhe një herë Kapitenit kokëshkretë që të dorëzohej. Ai u përgjigj: **"Mos lehni si qen se ujku nuk trembet"**. Ndërsa Komandanti nuk tundej aspak, Prefekti Abedin Nepravishta, dhe stafi i oficerëve të tij i propo-



Ferid Frashëri

zuan Feridit që të dorëzohej se nuk kishte rrugë tjetër. Feridi u ishte përgjigjur: **"Ai që guxon të përmend fjalën dorëzim e merr pushka në lule të ballit"**⁶. Gjithë energji dhe guxim kontrolloi dritare më dritare në krahun nga vinin sulmet prej kazermës ushtarake duke parë gjendjen e pozicioneve, dhe ndërsa kishte hyrë në një dhomë dhe kishte nxjerrë kokën për të parë gjendjen e rrethimit të jashtëm e mori një plumb në kokë. E pikasi Gjelosh Marku i Shalës nga jashtë rrethimit. Gjithsesi kjo vrasje e bujshme që shënoi edhe rënien përfundimtare të fortesës zogiste akoma sot e kësaj dite ka brenda një mister. Nga disa zëra mes të cilëve dhe Spiro Kosova thuhej sikur dikush nga njerëzit e vet që gjendeshin brenda qëllloi nga pas krahëve për së afërmi në rrezë të shpatullës⁷. Ka patur zëra të cilëve u është referuar edhe studiuesi Halim Shpuza se kjo vrasje ishte vepër e Musa Jukes dhe Abedin Nepravishtes⁸. Sipas kujtimeve

4 Marenglen Verli. "Shqipëria e vitet 1912-1964 në kujtimet e Spiro Kosovës". vëll. parë. botim i Klean sh.p.k. Tiranë viti. 2008, fq. 246.

5 Marenglen Verli. "Shqipëria e vitet 1912-1964 në kujtimet e Spiro Kosovës". vëll. parë. botim i Klean sh.p.k. Tiranë viti. 2008, fq. 249.

6 Marenglen Verli. "Shqipëria e vitet 1912-1964 në kujtimet e Spiro Kosovës". vëll. parë. botim i Klean sh.p.k. Tiranë viti. 2008, fq. 249.

7 Marenglen Verli. "Shqipëria e vitet 1912-1964 në kujtimet e Spiro Kosovës". vëll. parë. botim i Klean sh.p.k. Tiranë viti. 2008, fq. 249.

8 Halim Shpuza Disa ngjarje të Revolucionit të Qershorit në Shkodër artikulli studimor botuar në librin "Revolucioni i qershorit në kujtimet e bashkëkohësve" Sh.B.8 nëntori tiranë 1974, fq. 227.

të Gjon Marashit, Babun Celit, Martin Marashit, Vuksan Lekës, Prekë Sokolit Binak Pjetrës, Pal Mëhillit pjesëmarrës në atë rrethim, vlen të theksohet se Gjelosh Marku, së bashku me ta ka qënë në pritë para Prefekturës dhe ka qëlluar nga pozicioni përballë dritares ku mbeti i vrarë komandanti i qarkut. Ajo që dihet në mënyrë të qartë publikisht është se në atë çast faqe të gjithëve Gjelosh Marku pohoi me gojën e vet para të gjithë rrethuesve: **"Unë e vrau Ferid Frashërin dhe në shenjë triumfi vari një shami në tytë të manxerrit të vet"**⁹. Në ngjarje të tilla gjithmonë janë dhe mbeten



Gjelosh Marku

të diskutueshme dhe pikërisht tek këndvështrimet e ndryshme dhe psetë e shumta njerëzore qëndron kureshtja e në lidhje më skemën e padeshifruar të zhvillimit të tyre. Në rastin konkret vrasësi i Ferid Frashërit ka një emër të përveçëm që quhet Gjelosh Marku që ditën e madhe të taksiratit tha; -Unë e vrau Ferid Frashërin. Ishin shokët e tij pritës që i thanë: Të lumtë pushka! Ishte qeveria që e shpalli fajtor dhe e dënoi me vdekje por ishte edhe vetë Gjelosh Marku që nuk i ra mohit në gjyq një veprë të tillë për të cilën u dënua si heretik dhe vdiq si hero.

SI E VARI NË LITAR AHMET ZOGU, PATRIOTIN GJELOSH MARKUN

Kush ishte Gjelosh Marku?!

Gjelosh Marku nga fshati Nënnavriq i Shalës, zinte një vend nderi në almanakun e plisbardhëve të këtij fisi të vjetër, burrë

i sprovuar me punë dhe vepra trimërore atdhetare. Një emër i përveçëm që ka mbetur i fiksuar në kujtesën e kohës, me kesule të rrumbullakët e perçe në butë të kokës si dikur motit. Trim i paepur kur e donte puna me ruajtë erzin personal, nderin e krahinës e të vatanit. Për fjalën vetëm vdekja e anulonte dhe shuante si premtim. Bujarinë e kishte në gjak, tërvësën e shtronte trimërisht deng (*bukë, djathë, mish, venë, raki, tlyen e bulmet*), pasi kishte shtëpinë si mali me dushkë e me barë, plot gja e mallë të siguruar me djersën e ballit dhe shikën e dorës. Kullës së tij me çardak druri i gëzoheshin trentë mbi shkorsë, kur zoti i binte ndonjë mik të njohur e të panjohur apo edhe shtegtarin që e sillte drumi në shteg të oborrit. Gjelosh Marku në ngjarjet me kulmore të fillim shekullit të XX u gjend krah për krah me Mehmet Shpendin, Lush Prelën, Avdi Kolën, Çun Nikën, Marash Delinë e burra të tjerë të Dukagjinit me 1910 e 1911 kundër turqëve dhe me 1915 kundër malazezëve në Qafen e Boshit. Ky trim sygacë, ishte dhe mbeti antizogist i betuar, gjatë klimës së paqëndrueshme politike të viteve njëzet. Si mbështetës i forcave të Fan Nolit, doli koçak kundër qeverisë, që protagonist i qëndresës së armatosur kundër forcave qeveritare me 16 maj 1923 në Shkallën e Thethit dhe më pas afër Urës së Shalës. Ai ka qënë një nga bashkëluftëtarët më të ngushtë të Ndokë Gjeloshit, Vas Kirit, Dom Loro Cakes, dhe përkrahës i kandidatës së Luigj Gurakuqit, si përfaqësues i opozitës në vitin 1923.

Ishte ndër të parët zjarrtarë që rrethoi Nënprefekturën e Dukagjinit në mbremjen e 29 majit 1924 dhe dëbimin e autoriteteve qeveritare nga Dukagjini. Marshoi gjithë entuziazëm së bashku me dhjetëra vullnetarë të tjerë përkrahës të opozitës, vihet në mbështetje të forcave të Ushtrisë Kombëtare të komanduara nga Kolonel Rexhep Shala, Vas Kiri, Spairo Kosova, Ndokë Gjeloshi në sulmin mbi prefekturën e Shkodrës, natën e 31 majit 1924, sulm i furishëm që vazhdoi pandërprerje për plot 12 orë rresht.

Me 8 qershor 1924 mori pjesë në përbërje të detashmenteve vullnetarë të Kapiten Ndokë Gjeloshit e Toger Vas Kirit në sektorin Gjadër-Kodrat e Lezhës mbi forcat qeveritare të Nënprefekturës Lezhë, aksion që zgjati 4 orë ku pati 13 të vdekur e 6 të plagosur. Pas pushtimit të Lezhës sipas urdhrat të Komandës se veprimeve luftarake u stacionua së bashku me vullnetarët e tjerë duke pritur veprimet e mëtejshme të pararojës së Ushtrisë Kombëtare nën komandën e Ndokë Gjeloshit, e cila hyri në mënyrë spektakolare në Tiranë. Gjatë këtij inkursioni përtej Milotit mbeti i vrarë edhe Kolë Sejdia i Shalës¹⁰. Camillo Libardi në kujtimet e veta në lidhje me kryengritjen e Shkodrës dhe marrje e prefekturës ka nënvizuar rolin e Gjelosh Markut në zhvillimin e aktit final të

10 Libardi "Si u bë mbret i Shqipërisë Ahmet Zogu". Sh.B."Naim", Tiranë 2012, fq.35

1 Marenglen Verli. "Shqipëria e vitet 1912-1964 në kujtimet e Spiro Kosovës". vëll. parë. botim i Klean sh.p.k. Tiranë viti. 2008, fq. 181

2 Camillo Libardi "Si u bë mbret i Shqipërisë Ahmet Zogu". Sh.B."Naim", Titanë 2012, fq.32

3 Libardi "Si u bë mbret i Shqipërisë Ahmet Zogu". Sh.B."Naim", Titanë 2012, fq.33

DUKAGJINASI, LIN DEDE GURI, MIRENJOHJA E QYTETIT SHKODER

Me datën 22 maj 2015, në hollin e Tearit "Migjeni", u zhvillua ceremonia e dorëzimit të titullit "Mirenjohja e qytetit Shkoder", zotit Lin Dede Gurit.

Në këtë ceremoni moren pjesë familjare e miq të Lin Gurit, mori pjesë deputetja Jozefina Topalli, kryetari i Bashkisë të qytetit Shkoder, Lorenc Luka, Kryetari i Këshillit të Qarkut Shkoder, Maxhid Cungu e të tjerë.

Ceremoninë e hapë dhe e drejtoj artistin Bruno Shllaku, i cili pasi beri prezent se, kush është Lin Dede Guri, i dha fjalën kryetarit të shoqatës të Pernjekurve politike, dega Shkoder, Zenel Dragu, foli sekretari i Shoqatës së Pajtimimit Mbare Kombetar, Pjetër Vat Nika dhe Filip Guraziu. Pas një recitimi në mënyrë të shkëlqyer, nga poezite të Ndreks Gurit, nga aktori Bruno Shllaku, fjalë ju dha kryetarit të Këshillit të Bashkisë së qytetit Shkoder, av. Bardhyl Lohja. Av. Bardhyli pasi foli për punën e zotit Lin, si anetar i Këshillit prej disa ligjeraturave, lexoi vendimin e Këshillit, që i jep titullin "Mirenjohja e qytetit Shkoder", me motivacion: "Për kontributin e dhënë në vendosjen e pluralizmit në Shqipëri dhe si misionar i palodhur, duke u bërë faktor vendimtar për shuarjen e konflikteve dhe pajtimin e gjaqeve".

Pastaj e mori fjalën Lin Guri, i cili me emocion pershendeti tye pranishmit, falënderoi Këshillin e Bashkisë për vlerësimin që i kanë dhënë dhe në fund ftoi të pranishmit në një koktejll...

Kush është Lin Dede Guri?

Lin Dede Guri, rrjedh nga familja e nderuar Mhill Kola.

Lin Dede Guri, i sa po nderuar kohët e fundit me titullin e lartë "Mirenjohja e qytetit Shkoder", lindi në Brashtë të Shoshtit, atje mbi një rrafsh të lartë, tipike alpine, ku malet puthën buzë për buzë me qiellin: Lin Dede Guri vlerësohet me titullin "Mirenjohja e qytetit Shkoder" është vazhdimi i një gjenerate të fisme të materializuar në kullë të lashtë të kamur e bujarie tipike malësore:

Gjyshi, Mhill Kola, ishte një burrë i dëgjuar i fjalës dhe veprave të dobishme, që e

kishte kallë barutin e kordumës kundër Turgut Pashës me 1910 dhe shkëve me 1915, respektivisht në dy qëndresat më monumentale të Dukagjinit në fillim të shekullit të kaluar.

Shtëpia e Mhill Kolës ka qenë një shtëpi shekullore nga më të mëdhatë e më të pasurat e Shoshtit ndër vite. Të rralla kanë qenë ato shtëpia që i kishin të gjitha tufat (tubtë) të



mëdha (dele, dhi, lopë, qe, bletë e mushq), si shtëpia e Mhill Kolës së Brashtes. Të rralla kanë qenë ato shtëpia aq punëtore dhe të razishme me livadhe, prozhme, hamalla e bashina. Shtëpia e Mhill Kolës dhe më pas Dedë Mhillit kanë qenë punishte bulmeti ku binin në sy varg tinarët e djathit, qypat tlyenit, govatat e tamblit, shekat e kosit të kulluar, ku as një herë i vjetri nuk shterohej, pa i bërë shoqëri të riut. Në shtëpinë e Mhill Kolës kurrë nuk është shtruar tërvesa për mik, rrugëtarë, punëtorë apo lypsarë, pa currekun e djathit, pa bludën e mazës ose fulteren rrash me tlynë, pa vegshin plot dyreçka mishi dhe më pas sahanin çabullit (enë alumin për dhjetë veta) plot e përplot tambël ose kos.

Dedë Mhilli (babai i Lin Gurit), ishte i gatuar gjenetikisht si antikomunist. Në ato kohë zyrtar nuk pati mundësi shkollimi, por ama

kanunin e dinte fill e për pe. Ishte atdhetar e trim se ja mbante tabani, ishte bujarë e besnik se ja mbante dera, ishte i gojës se ja kishte bërë dhuratë Zoti. Gjatë viteve të luftës militoi në radhët e Ballit Kombëtarë, ka qenë dhe vdiq kundërshtarë i betuar PKSH. Në nëntor 1944 shkoi në mbështetje të qëndrestarëve të Nikaj-Merturit në Qafën e Kolshit kundër forcave të Brigadës 6 Sulmuese të UNÇ.

Nuk u pajtua me regjimin e ri, të cilin e urrente si sistem dhe si ideologji, prandaj si kundërshtarë i betuar dhe i deklaruar u pushkatua në mënyrë tipike jakobinë, pa gjyq përpara popullit të Shalës, në Breg të Lumit, në vitin 1946, nga Shefi i Seksionit të Sigurimit të Rrethit Dukagjin, N/Toger Xhemal Selimi, i akuzuar në mënyrë bajate gjoja për armëmbajtje pa leje. Ekzekutime të tilla terroriste, të modës bolshevike bëheshin për të larë hesapet me kundërshtarët politik dhe për të ngjallur frikë dhe panik ndaj çdo kujt që mendonte e vepronte ndryshe.

Lin Guri në moshën minore mbeti jetim (së bashku me vëllezërit dhe motrat e tjerë, secili e më vocërrak se tjetri). U rrit me sakrificë nga nëna Drande dhe dy xhaxhallarët e vet, Luleci dhe Liku, u rrit me një edukatë të shëndetshme, ndonëse nuk pati mundësi të shkollohej përtej shtatëvjeçares, pasi konsiderohej si djalë armiku. U rrit me edukatën e punës, mirësjelljes në shoqëri, larg intrigave e dallavere të çdo lloji duke punuar fort, duke qenë korrekt, duke folur pak, duke respektuar njerëzit e punës. Lin Guri me shikën e dorës dhe djersën e ballit mbajti shtëpinë, ndonëse me biografi të jo për kohen, por me cens karakter shembullor në gjithë krahinën e tij. Lin Guri, u rrit, u martua dhe krijoi një familje të virtytshme sipas shembëlltyrës së vet, të respektuar në Shosh, Shalë e gjithë Dukagjinin. Sa do e ashpër ka qenë lufta e klasave, në Dukagjin nuk ka qenë fyese të quheshe i prekur politikisht. Ishte e rrezikshme të kishe njerëz të pushkatuar në familje, por në sferën shoqërore e të fisit, po që familje si ajo e Lin Gurit, ishte e nderuar në heshtje. Vitet nëntëdhjetë ishin një ogur i mirë dhe i shumë pritur për Lin Gurin, i cili që nismëtarë i lëvizjeve të para demokratike në Shkodër, Dukagjin

dhe gjetkë. Lin Guri ka qenë kudo përkrah Ali Spahisë, Pjetër Arbrorit, Azem Hajdarit, Arben Brocit, Viktor Martinit, Nikolin Thanës, Ali Kazazit, Pjetër Pepes, Lodovik Dëgës, Dedë Kasnecit, Dedë Tokës, Kolë Tonajt, Ndoc Ashtës, Faze Shabës, Menduh Dergutit, duke vijuar më Astrit Bushatin, Jozefina Topllin, Lorenc Luken Voltana Ademin, Ramiz Çobën e të tjerë. Linë Guri është i pari anëtarë i Këshillit Bashkiak nga komuniteti dukagjinasi, i qytetit të Shkodrës, pas viteve nëntëdhjetë. Linë Guri është anëtarë më i vjetër dhe më i shumë zgjedhur, tre mandate. Ai ka qenë një zëdhënës dhe përfaqësues energjik i këtij komuniteti, në parlamentin e qytetit. Ka qenë iniciatori i krijimit dhe emërimit të rajonit "Mark Lula", ka ngritur zërin kritik për integrimin urbanistik të këtij rajoni dhe ka ushtruar ndikimin e vet në realizimin e atyre investimeve infrastrukturore që janë bërë, me të cilat as njëherë nuk ka qenë i kënaqur. Me propozimin e Lin Gurit, Këshilli bashkiak i Shkodrës në mënyrë unanime ka miratuar shpalljen "Qytetar Nderi i Shkodrës" së Prof Kolë Prelës, deputetit historik të martirizuar të Dukagjinit. Linë Guri, me plot përkushtim, vitalitet e energji pa bujë dhe autolevdata ka punuar si drejtues i Shoqatës së Burgosurve Përndjekurve Politik, Dega Shkodër, që nga themelimi i saj. Ka punuar për evidentimi dhe vlerësimin e sakrificave të tyre martire, ka luftuar për të drejtat dhe rehabilitimin e tyre. Lin Gurinë as një rast nuk i ka rënë gjoksit, as nuk ka bërë tellaxhiun e një të shumë vuajtur ashtu siç ka qenë vërtetë, pasi një gjë si dihet dhe shihet nuk ka shumë nevojë të tregohet me gisht. Gjithashtu i heshtur, modës, fjalë pak e punë shumë, ka punuar edhe në dhjetëra raste pajtimi gjakesh, hasmërisht dhe zgjidhje konfliktesh, pasi si njeri me reputacion dhe peshë fjalë i ka zënë vend për mirë, pasi fjalët dhe veprat nuk i ka ndarë në shërbim të komunitetit.

I nderuari Lin Dede Guri, e gëzosh titullin e nderit "Mirenjohja e qytetit Shkodër"!

Përgatite nga
Prele Milani

kësaj drame historike të paharuar "Lufta zgjati gjithë natën.

¹¹ Të nesërmen kur Feridi dhe të besuarit e tij ishin të lodhur e ndërkohe u ishin mbaruar gjithë municionet, u kacavarren nga ana e prapme e pallatit të prefekturës, nga ku shihej një kopsht **Gjelosh Marku nga Mekshajt e Shalës me të tjerët e të njëjtët fis, kishte ndryshuar pozicionin dhe kishte zënë vend prapa prefekturës. Nga poshtë u dëgjua një e shtënjë, e cila u ndoq nga një britmë e mbytur dhe rënkime. Heroin e pamposhtur e kishte goditur në kokë dhe ra siç bien të fortët. Kaluan disa minuta me një qetësi të tmerrshme.**

Pas pak u pa një flamur i bardhë nga një dritare i mbajtur nga të besuarit e tij. Prefektura u mor, Partia e Zogut dukej e plagosur për vdekje¹². Opozitarin antizogist Gjelosh Marku e patën arrestuar forcat e Muharrem Bajraktarit së bashku me Lekë Vuksanin, ku i morën të lidhur me zinxhir (rebeli i lidhur me duar prapa, me hekura nemeje të vendosura deri

në zero, rrugën nga Shala në Shkodër e bëri në kembë dhe nuk u lejua as të hante bukë, as të pinte ujë, as të pinte duhan, ndonëse i dridhej buza për një cigare, nënvizimi im PM) Gjeloshi, kur mbërriti Muharrem Bajraktari në Shalë u arratis nëpër pyje e nëpër male¹³, ndërkohe që koçaku ishte paralajmëruar se po të mos dorëzohej, do t'i digjej kulla e stani, do t'i konfiskohej malli e bagëtia dhe familja do t'i burgosej.

Duke u besuar edhe fjalëve të bukura të disa bashkëpunorëve vendas të Muharremit, vendosi të dorëzohej e të mos jetonte malit si gje, dhe së paku të mos rrezikonte gjithë familjen. Erdhi direkt nga mali, u dorëzua në qendër të Nënprefekturës në Kodër Shën Gjergj dhe nga aty e dërguan në Burgun e Shkodrës. Gjyqji special politik e dënoi si nxitës dhe pjesëtar të revoltës së armatosur për përmbysjen e rrëgjimit kushtetues, si kriminel me duar të përgjakura dhe vrasës i Komandantit të Qarkut Shkodër Kapiten Ferid Frashërit. Vlen të theksohet qëndrimi fisnik i Gjelosh Markut në Gjyq

kur u pyet nga Kryetari i seancës se kush e vrau Ferid Frashërin. "**Së pari Lek Vuksanin mos e përzeni në këtë punë e mos e merri në qafë pa pikë fajit. Ferid Frashërin, nëse plumbi e ka marrë me qatë plumb e kam shytue unë. Ferid Frashëri nuk është një burrë me shkua gjak hupun. Nëse duhet të përgjigjet kush për vdekjen e tij, qe ku më keni**"¹⁴. Unë e vra-va, ishim në luftë, në luftë nuk shkohet me u puthë, por me u gjuajt me plumba. Pushka e vret, por e nderon burrin. Qe ku me keni, jam dorëzua në besën tuaj dhe nuk kërkoi mëshirë! Çdo gjë e kam bërë me dëshirë kundër këtij regjimi të mallkuar, ndërsa me Ferid Frashërin nuk kam pasur asgjë personale, por siç e thashë kemi qenë në dy llogore kundërshtarë¹⁵. Vdiq me ndjenja të krishtera, iku nga kjo

¹⁴ Treguar nga Gjon Marashi i Shoshtit, pjesëmarrës në këto ngjarje, intervistuar nga ana ime 27 shtator 1985. Këtë fakt e pohojnë në kujtimet e tyre Dedë Binaku 85 vjeç dhe Lazër Pali 80 vjeç. Pepaj Shosh të cilët u referohen kujtimeve të prindërve të tyre Binak Pjetër dhe Pal Mhillit, bashkëlufetarë të një prite të Gjelosh Markut. Asnjëri prej informatorëve nuk pajtohet me asnjë version tjetër të vrasjes së Ferid Frashërit, ndërkohe që guximin e Gjelosh Markur për të mos e mohuar këtë gjë as në hetuesi as në gjyq e quajnë sin-keritet dhe guxim të tepruar.
¹⁵ "Shqiptarja.com" dt 02.06.2013

botë si hero. Nuk u tremb dhe fytyra e tij nuk pati asnjë shenjë frike, e varën në litrar aty tek "Fusha e druve. Nuk ju mohua prania e një prifti. Ai quhej At Giuseppe Lchman"¹⁶. Varja u bë publike me tellall. Viganin e therrorizuar e lanë gjithë paraditen varur për t'i shti tmerrin njerëzisë. Trupi i tij u varros në Shkodër dhe nuk u lejua që ta merrnin familjarët (vetëm pas 6 muajsh u lejua nënvizimi P.M).

Në Shalë shungulloi gjëma e burrave të fiseve siamez të Dukagjinit, sa drithëroi gjithë bjeshkët. Vajtorët qanë me kujë dhe derdhen lot pikëllimi mbi rrobat që vishte trimi kur shkante në festa e krushqi. Martiri në ditën e lamtumirës nga kjo jetë prehej diku në një vend, groposur si dre i plasur nga helmi, i ndëshkuar si heretik i regjimit të Ahmet Beut dhe tradhtar i atdheut. Gjelosh Marku u flijua në një skenë epiko- tragjike për idealet e tij opozitare.

Përgatite nga
Prele Milani

¹⁶ Camillo Libardi "Si u bë mbret i Shqipërisë Ahmet Zogu". Sh.B."Naim", Tiranë 2012, fq.63

¹¹ "Ora e Maleve" 13 qeshor 1924

¹² Libardi "Si u bë mbret i Shqipërisë Ahmet Zogu". Sh.B."Naim", Tiranë 2012, fq.34

¹³ Libardi "Si u bë mbret i Shqipërisë Ahmet Zogu". Sh.B."Naim", Tiranë 2012, fq.63

NË TUZ, MES HISTORISË DHE HARRESËS ...

Me Ramazan Çeken, poetin e gazetarin shkodran, udhëtojmë drejt Tuzit, qytetit shqiptar në Malin e Zi, më pak se 10 km nga pika kufitare e Hanit të Hotit.

Në shoqërinë tonë është Gjon Dushaj, kryetari i shoqatës "Ded Gjon Luli", një djalë me shpirt artisti por edhe një vepërimtar i njohur për çështjen shqiptare.

Ka trembëdhjetë vite që drejton shoqatën dhe ansamblin folklorik me të njëjtin emër por na thotë se është edhe një ndër organizatorët e ditëve festive në përkujtimet vjetore të kryengritjes së Malësisë së Madhe, shenjtërimin të Nënë Terezës e ditës së Flamurit, çdo 28 nëntor.

Gjoni na tregon për jetën e vëllezërve tanë të asaj ane dhe nuk e fsheh që shpesh herë janë të mënjantuan nga shteti amë dhe pse venë e vijnë në të dy anët, lirshëm.

E ka merak që ende asgjë e dallueshme nuk është bërë për njërin prej figurave të mëdha të shqiptarisë, Ded Gjon Lulin, i cili nuk vjen nga legjendat por nga kulla e tij e gurtë, aty në Bardhaj, 12 km prej Tuzit nga ku fusha e Malsisë së Madhe duket si në pëllëmbë të dorës.

Dhe bëhet fjalë për prijsin e kryengritjes së Malsisë së Madhe, njeriun që një shekull më parë ngriti Flamurin Kombëtar në Deçiq.

Vetëm një bust fare i vogël për këtë burrë të madh lirie, aty në një qendër të Tuzit, është fare pak. Ca më keq që as nga presidenca shqiptare ende s'ka mundur të dalë një vlerësim kombëtar për këtë prijs e luftëtar lirie.

NË SHTËPINË MUZE TË SHTJEFËN IVEZAJ

Gjon Dushaj na fton të bëjmë një vizitë në shtëpinë e Shtjefën Ivezajt në Lekaj, vetëm dy km nga qendra e Tuzit.

Siç na thotë, Shtjefni është njeriu që shtëpinë e tij e ka kthyer në muze e që, për vizitorët, ka disa vite që është bërë pjesë e guidës turistike, ndonse jashtë protokolleve e axhendave zyrtare.

I zoti i shtëpisë, Shtjefni, na pret në oborrin përpara saj, aty ku mbi barin e gjelbërt zënë vend disa prej objekteve muzeale të "artilerisë" së rëndë, derdhur në metal.

Na pret plot dashuri, si të njihemi prej kohësh, i veshur shik si për një ballo klasiqe por edhe si një ciceron profesionist.

Në hyrje të shtëpisë, një ndërtesë e thjeshtë një kateshë, të tërheq vëmendjen një tabelë e kornizuar ku shkruhet: "Më 1 maj 2002, Shtjefën Ivezaj me familjen, këtë shtëpi familjare e shndërruan në muze Etnografik të Malsisë".

Brenda, ku të futesh. Të katër ambientet e shtëpisë plot e përplot me eksponate, në faqet e mureve, në dys-heme, në tavan, kudo.

Zanatit të fotografit me të cilin ka punuar tërë jetën i ka sajuar një aneks më vehte, dikur ballkon por që tani brënda kësaj hapësire mund të shikosh lloj-lloj aparatësh e paisjesh qysh nga koha e primitivitetit.

Ka qenë vetëm tetëmbëdhjetë vjeç kur ka nisur të merret me fotografinë nga

ku prej vitit 1966 në dyqanin e tij në Tuz do të vendoste tabelën "Foto Shtjefën Ivezaj" të cilën, si relike, e ruan të vendosur diku në hyrje të banesës muze.

Pastaj vijnë me radhë "pavjonet" e ndara në katër dhomat e shtëpisë ku më së shumti bie në sy etnografia e pasur, madje e rrallë.

Kam patur rastin të vizitoj mjaft muzeume etnografike brenda e jashtë vendit por kurrësi e asnjëherë nuk kam parë një muze të tillë.

Dhe kur mendon se gjithshka këtu është bërë nga një njeri pasionant e pa asnjë ndihmë nga dikush shfaqia merr përmasat e të jashtëzakonshmes.

Nuk jam i sigurtë si funksionon por nëse do ishte aq shumë perfekt, të paktën Shtjefën Ivezaj do ishte futur me kohë në Gines.



Sado i futur diku në një cep të globit, aty në Lekaj të Tuzit do të ishte gjetur.

Dhe duhej të gjendej aspak për nevojë të Shtjefnit për tu dukur por për të treguar një mrekulli të realizuar nga një njeri.

Gati e pa besueshme por duhet të jetë njeriu i vetëm në këtë botë që shtëpinë e vet, rreth njëqind metra katror ta kthejë cep më cep në një muze të mirëfilltë etnografik.

Po edhe fototekë, bibliotekë e filateli. Shtjefnit tani është afër të tetëdhjetave e ndonse duket tepër vital të parën gjë që të thotë kërkon ta lidhë me jetën dhe vdekjen.

Tani jam i vdekur, kur të vdes do jem i gjallë - na thotë duke dashur ti japë përgjigje habisë tonë.

Është një thënie, domethënien e të cilës e kupton mbasi i ke dhënë fund vizitës plot objekte e materiale të shumë llojshme e të rralla, të gjitha të përdorura në shekuj nga shqiptarët e asaj ane e që fillojnë prej majës së gjilpërës e deri tek topat me gjyle të rënda.

Është muze që nuk ka inventar, besoj si

asnjë tjetër në botë. Dhe nuk ka si të ketë mbasi është gati e pa mundur të hedhësh në letër ato mijra objekte që lidhen me jetën e njeriut prej lindjes deri në vdekje. Objekte të rralla materiale të trashëgimisë kulturore që do ti kishte zili cilido muze i kësaj fushe edhe në vendet më të zhvilluara.

Të mbledhura nëpër ditë e vite, një pasuri e rrallë në një kohë gati dyzet vjeçare. Pa asnjë përkrahje dhe përkujdesje nga dikush, asnjë dorë shteti apo pushteti, përjashtuar komunën e Tuzit me ndihmesa modeste.

Gjithë ditën punoj, gjithë natën e ruaj - na thotë i zoti i shtëpisë - muze dhe këtu nuk lë pa falenderuar edhe bashkëshorten e tij, Gjysten, me të cilën dëshiron të ndajë përpjekjet dhe andrallat për gjithshka ka realizuar një jetë të tërë.



NJË LETËR PËR PRESIDENTIN...

Në koridorin e vogël ku bashkohen të katër dhomat është vendosur një tavolinë e vogël me një libër të madh përshypjesh që të fton të ndalesh.

Shënime përshypjesh të pa numërta nga vizitorët e rastit. Nga të gjitha trojet shqiptare por edhe ambasadorë të

Francës, Gjermanisë, Italisë etj. Midis faqeve të librit gjen përshypje edhe nga mjaft njerëz të artit e kulturës, studiues të fushave të ndryshme.

Po Shtjefën Ivezaj e ka një merak e nuk heziton ta thotë.

Përpara pak ditësh në Tuz ka qenë për vizitë Presidenti i Shqipërisë, ka menduar se do ta kishte mysafir të nderuar por kjo nuk ka ndodhur. Më kot ky burrë Grude ka pritur në shtëpi.

E di që nuk ma ka fajin Presidenti - na thotë, të zotët e vendit duhet ta binin atë këtu.

Ja ku jemi, vetëm dy km nga qendra e Tuzit ku Presidenti qëndroi për vizitë.

Do ti shkruaj një letër e do ti tregoj, nderi nuk do ishte thjesht për mua e familjen time por për të gjithë historinë e Malsisë - na thotë jo pa keqardhje.

Këtu prehet e trukon historia e kësaj ane, këtu valvitet flamuri kombëtar që ngriti në Deçiq gati një shekull më parë Ded Gjon Luli.

NË VEND TË MBYLLJES

I mrekulluar dhe befasuar nga sa pashë në muzeun e Shtjefën Ivezaj do hidhja disa përshypje të shoqëruara me foto në adresën time në rrjetin social.

Më bënë përshypje komentet e vërsuara sa kaq nga shumë miq të mi nga të gjitha trojet shqiptare.

Dikush shkroi edhe më konkretisht mbasi në publikimin tim paralajmëroja botimin e përshypjeve përmes një shkrimi në gazetën "Telegraf".

Për lexuesin, nga komentet e shumta kam shkëputur dy prej tyre. I pari vjen prej Prishtinës, i dyti nga një shqiptar i Shkupit. I përzgjedha këto pasazhe edhe si mbyllje të shkrimit tim në "Telegraf".

Berat Luzha, Të bëhet një muze privat aq i pasur, një ekspozitë aq interesante nga dy të moshuar në një shtëpi të vogël, është një mrekulli e vërtetë, çfarë, pa e parë, nuk do të mund të besohej. Padyshim se Shtjefni ka bërë një punë të shkëlqyer për popullatën shqiptare në Mal të Zi dhe për tërë kombin shqiptar!

Ismet Shaini, Me vemëndje për vite të tëra e përcjellim përkushtimin dhe sakrificën e z. Shtjefën Ivezaj.

Pasi lexova statusin tuaj u nxitë të jap një sygjërim-lutje deri te gazeta "Telegraf". Nëpërmjet kontributit të gazetës tuaj të senzibilizohet në parlamentin e Malit të Zi edhe çështja e Muzeut Etnografik (Statusi, mirëmbajtja, financat, me një fjalë institucionalizimi i kësaj shtëpie të bekuar për traditën dhe kulturën shqiptare).

Shtjefën Ivezaj me familjen nuk do të jetojnë përgjithmonë por muzeu i trashëgimisë kulturore në Malësi duhet të mbetet për brezat e ardhshëm që do të jetojnë aty dhe gjetiu,

Andaj lusim për angazhim më serioz si nga gazetarët, deputetët dhe instancat më të larta shqiptare në trojet autoktone...

**Nga Sejmen Gjokoli,
Tuz - Vlorë,
25-29 Prill 2015**

Thesaret dukagjinase e pathëna që i ka munguar një krahine

VOC DEDA, PATRIOT DHE ARTIST I FJALËS SË SHKRUAR, CILËSOHET TË JETË INDIVIDUALITET I SPIKATUR NË HITERLANDIN DUKAGJINAS QË SHTRIHET NË TRE SHTETE TË EVROPËS JUGLINDORE

5. (vijon)

Nuk rresht çerleku i fjalëve me aromë në sagën e vël-limshme të pagëzuar me termin gjithë impulse, "Thesare Dukagjinase" të autorit tashmë emblematic në këtë rrafsh, Voc Deda. Sonda e hulumtuesit të visareve ndeshet shpesh në shtresime historishë me dukuri jo dhe aq të dobishme për një shoqëri ku integriteti sajdiset si vlerë morale e podit të epërm. Çprej kohërave më të largëta kur mbretëronte në trojet e të parëve të Voc Dedës, hiena e paganizmit, një taborr me bestytni e paragjyqime i bëjnë lëmsh dhe i trallisën mendjet e shpirtërat në Dukagjinë e më përtej hiterlandit të kësaj krahine me kufij që tentojnë t'ja shtojnë vrimat rripit të mesit. Autori i "Thesare Dukagjinase" e mban hapur derën e odës për të dalë jashtë pa zhurmë e pa bujë, e sa më shpejt të jetë e mundur, të xhindeve që provokojnë herezi e blasfemi. Në librin e tretë të sagës "Thesare Dukagjinase" autori ia del të portretizojë kumte pozitive që vishen me petkun e prover-bave, thëniet të mençura të princave të fjalës së urtë e të butë, e teefundit dhe si prova të shkencës e teknikës, teksta ngarendin për të na e pastruar përditshmerinë nga banalitetet dhe ekstremitetet e këtyre të fundit, mbartës duhme, që duhet kanalizuar në një lloj hullie ku erërat e rrafshit nuk mbërrijnë.

Voc Deda mëton të na bindë në vëllimin e pestë të serialit narrativ "Thesare Dukagjinase", se duhen hejbe aq të mëdha që përdorën në parahistori ciklopët e gjëmimshëm, për t'i bërë bashkë e veçmas, përrallat e legjendat, këngët, vajet e folklorin, ku përmbledhen kashelashat e ligjërimet folklorike, pambarimisht të bujshme. Traditat e përshtatshme për një komunitet njerëzor me gjenerata pambarim që jeton mbi syprinën e kësaj toke si vizionar e si misionar, janë shumë. Ato evidentohen në libër një nga një. Ka të drejtë në se ndokush pasi ta ketë lexuar vëllimin e fundmë të "Thesare Dukagjinase", të shprehet se nuk janë rrasë në kubaturën e librit kaq e aq zakone e tradita; të hershme fort e të reja tepër. Ky fenomen ndodh shpesh me lexuesit në adresë të narratorëve


me koracë e luspa përsipër. Me çka duket ende nuk jemi edukuar dhe aq më tepër ende nuk jemi bindur se një krijesë njerëzore nuk mund të mbajë mbi kurriz hambarin e të gjitha dijeve njerëzore. Voc Deda në rastin konkret të duket sikur shprehet me modesti: kaq dita e kaq shkrova. Po unë them se autori i talentuar dhe ambicioz ka bërë të kundërtën. Dhe sall për këtë fakt kockëfortë duhet të duartrokitet.

6.

Vëllimet pasuese që përbëjnë korpusin e shkrimtarisë së Voc Dedës mbrujanë në magjen e krijimit tematika të larmishme, e sejcila prej tyre peshon rëndë në kandarin e vet. "Bisedime me rininë" është titulli pa pretendime i librit të shtatë që vjen në radë për tu bërë pronë e lexuesit. Tërheqja e vëmendjes për të trajtuar tema delikate e me çmim të shtrenjtë, nuk ka qenë një dukuri masive tek shkrimtarët në shekuj e ndër mote. Të rrahësh problematikën universale që e shqetëson rininë jo vetëm të vendit tënd, duhet në krye të herës durim. E pas durimit duhet guxim. As durimi dhe as guximi nuk do t'i mungojë as sot dhe as nesër autorit të "Thesare Dukagjinase". Shqetësimet rinore dalin nga guacka se shkrimtari e njëj zëjen e nxjerrjes prej andej. Ato qëndrojnë në kutizat e memories së shkrimtarit gjersa marrin format e nevojshme. Kur piqen e maturohen, çertifkohen dhe përcillen tek lexuesi bashkë me deklaratën e virgjërisë së tyre, më të brishtë se maza e qepës së Drishtit apo më të hollë se cipa e himenit.

Voc Deda ngulmon t'ju transmetojë pasardhësve të vet dëshmi të sigluara nga e djeshmja e largët dhe nga e sotmja e afërt. Ai nuk heziton të veshë pelerinën e hulumtuesit të zellshëm. Zbret shkallët e historisë e provon adrenalinën e njeriut që ka mbrritë në një cak ku vulllojnë impulse njerëzore. Zbulon si të ish një eksplorues i lindur se e vërteta del në dritë të diellit vetëm kur bëhet fli bërthama e saj. Has në visare, e thënë ndry-

she: në dokumente autentikë dhe autoktonë. Në paragrafë të disiplinuar këndshëm, konfigurron dhe përcjell imazhe e kolazhe të epokës së ndritshme të Atletit të Krishtërit në Europë, Gjergj Kastrioti-Aleksandër. Dhe



nuk ndalet këtu në vrujimin e kapitujve të librit të tetë me titull shprehës "Dokumente, data dhe shënime historike", Voc Deda. Ai na vizaton me ngjyra të ylberit rrokullimën e ndodhive që i bën karshillëk qëndresës sonë sublimë e solide. Coptimi i trojeve u mjaftua me krisjen e pashmangshme. Dhe i Voc Dedës dhe i të parëve të tij pësoi jo vetëm njëherë gjendjen e nokdaunit nga kollitja e Fuqive të Mëdha, por, ani, mbeti në këmbë buzë shtrëngatës e fladit të përherëshëm të fatit të vet të përjetshëm.

7.

Të shkruash një libër të vël-limshëm e t'i qëndisësh në ballinë fjalën e shumëpërfolur "Kuriozitetet", nuk është një aventurë narrative dosido. Autori sondon opinionin publik e në veçanti atë të gjeneratës më të re në vendin e tij. I rezultojnë të jetë ushqim shpirtëror stivimi i risive në histori, politikë, shkencë, e në atë gjendje transi ku përditshmëria jonë shkapetet e merr plagë që vënë kore shpejt e stisin brumin e qëndresës. Në faqet e librit rrinë mirë e bukur afër e afër shoshoqes, kumte për rrokaqiej e kozmos deri në një cep të skajshëm, të arritshëm. Lexuesi mëson për herë të parë ose fshin pluhurin e harresës në trinën e

kujtesës, për aliazhe e pasazhe, mirazhe dhe imazhe, të luftës së Dytë Botërore dhe të traumave të tjera që trallisën palcën e planetit. Voc Deda nuk harron të arkivojë portretet e stilizuar të njëqind individualiteteve që prekën me dorë realitetin shqiptar dhe që u shprehën me mjete divulgative për integritetin e një komuniteti në anën perëndimore të Mesdheut. Autori i librit "Kuriozitetet" me të drejtën e ligjshme që ka nën mëngë, shprehet me vërtetësi e pa kurrfarë nënteksti për personalitete të formatit të Gjon Palit të Dytë, Roza Lejn-it, Mari Edit Dyrham, Tereze Bojaxhi dhe lista nuk sos këtu.

Ka një vështrim të tijin Voc Deda në krahasimin e kësaj lënde që pulson pandalim. Ndodhitë që përbëjnë ngjarje i vrojton dhe i miklon. Për sa kohë shkenca, teknika dhe teknologjia kanë hecur me hapa galopante, është një gjeneratë njerëzore kjo e sotmja që kërkon të dijë se si nisi lundrimi i anijeve që përmbledh dijet e sotme të njerëzimit. Gjeneratën më të re në Shqipëri e ha merak të dijë se nga çfarë moli, kepi a porti u nis lundra e dijeve njerëzore. Voc Deda nuk shmanget të japë informacion për vendburime minerare, origjinën e botës bimore e shtazore, për shtrim shinash për autostrada detare e tokësore, galeri e muze nacionalë dhe ndërnacionalë. Në një dendësi të paparashikueshme informacioni, rrëfimi krijon hullinë e vet, e cila vetëm e mërztshme nuk është tekta lexohet me vëmendje në të gjitha etapet e ngjizjes së saj.

8.

Lexuesin e familjarizuar me krijimtarinë e Voc Dedës e bën mik e jëran dhe leximi i monografisë ku vaisen gjymtyrët e një vendbanimi të hershëm, i cili me sa duket është Kopësht Edeni për autorin e veprës së dhjetë të vënë stivë, me titull: "Historiku i fshatit Khan". Krijuesi tashmë mjeshtër i ngjizjes së fthillimit të rrëfimitarisë dokumentare, shfaqet i drejtpërdrejtë tekta përcjell një trung fisi me shumë degë e rrema. Të përshkruash me imtësi jo pak por 15 a 17 brezni njerëzore të një fisi të ngjuar në shkëmbeje

midis lisash gjithherë të gjelbërt, është sakrilegj që shndërrohet në virtut. Analiza është më e hollë se maja e gjilpërës. E vërteta shkencore plazmohet me respektin e ndërsjelltë të krijuesit me skrupuj monumentalë. Të kësaj natyre kanë qenë hulumtimet e Atë Gjon Shllakut, të Zef Valentinit, Atë Shtjefën Gjeçovit, Faik Konicës, Krist Malokit, Nebil Çikës, Marin Sirdanit, Benard Shllakut, Atë Gjon Karmës, Shtjefën Kurtit, Mustafa Mërlilikës (Kruja), Anton Harapit, Zef Pllumbit, Martin Camaj, Branko Merxhanit, Zef Nekajt e mjaft personaliteteve të qemerit të botës shqiptare në etapa të evolucionit të racës ilire e dardane. Voc Deda na prezanton me një bërthamë njerëzore që ka ekzistuar më tepër se 450 vjet më heret se kur hidhet në letër kjo memuaristikë e sinqertë dhe e këndshme për tu lexuar deri në rreshtin e fundmë të saj. Nga bërthama ka çelur një filiz, i cili vetminë nuk e duron aspak. Shtohet, domethënë me rrënjë të ngulura në toprakun e filizit të parë lindin filiza të tjerë, poaq të shëndetshëm e fisnikë si "bima" nistore. Pema i shton degët e bëshme, mandej krijohen rremat, edhe këta gjithë limfë e palcë bjeshke. Prap rretherrotull kurorës së pemës tashmë gjigante ka filizë të rinj e lule nëpër to. Nuk është një prozë dosido. Është një qendisje në avlëmënd nga gishta të stërvitur për këtë mjeshtëri të hershme qyshkur racës njerëzore iu tek të shihej në pasqyrë. Dhe të dukej e hijshme. Të konkuronte me Zanat e Maleve të larta sa fisnikëria e xhanasit fatlum dhe në se i dorëzohet me vullnet të lirë statusit të martirit.

Banorët e lisit të gjakut, të fisit me 15 a 17 brezni njerëzore frymojnë sot e gjithë ditën e lume në mal e në fushë, në bjeshkë e në vërrin, në Europë e në Amerikë, në Australi e në Kanada, në Britaninë e Madhe dhe në Zelandën e Re. Përkundër përhapjes që është e gjithkundshme, e larmishme është dhe gjeografia e profesioneve që ushtrojnë bijt e bijat e Xhanit në Shqipëri e jashtë saj. Ka ndërkohë trurin e vet kjo kore njerëzore e shtresuar në kohë të largëta e të afërta.

(vijon)

MALËSORI I SUKSESSHËM NGA DUKAGJINI

Në zemër të gadishullit të Ballkanit ngrihet madhështor një masiv i madh malesh që njihen në hartë me emërtimin Alpet e Shqipërisë, të cilët zënë rrënjë buzë liqenit të Shkodrës dhe përfundojnë në Malësinë e Gjakovës.



Ndjej një respekt të madh me shumë konsideratë për shkoderanin e suksesshëm me banim në Amerikë z. Ndue Ftoni, i cili është një ndër biznesmenët më të fuqishëm në Detroit dhe Michigan, por mbi të gjitha me një stacion televiziv shqiptar, ku promovohen vlerat e kombit tonë, duke u bërë kështu një ambasador i vërtetë.

Mund ta quaj atë mecenat, sepse i ndihmon të gjithë artistët në SHBA. Mund ta quajmë atë një njeri që ndihmon Shkodrën, sepse vjet organizoi për të parën herë dhe do ta bëjë të përvitshme "Nata Shkodrane", me humor dhe muzikë nga Shkodra. Sivjet dhe për çdo vit ai do ta bëjë në muajin maj dhe do ta quaj përsëri "Nata Shkodrane" dhe pjesmarrja siç ishte vjet prej 1 000 vetë, do të jetë përsëri edhe në vitet e ardhshme.

Po botojmë edhe tekstin e plotë të këngës e cila u realizua nga muzikanti i njohur Behar Neli, kënduar nga Nik Çarku, për të cilën u realizua edhe një videoklip shumë profesional nga stafi i tv "Kopluku", me mjeshttrin e talentuar Artur Hoxhaj.

BIR I DENJ' I DUKAGJINIT

Me telat e çiftelisë
Me lahuten e Malsisë
Si buron lumi i Kirit
Sot po m'del kanga prej shpirtit

Për një burr' në Michigan
Për veprat që ai po ban
Shpirt e zemër prej florinit
Bir i denj' i Dukagjinit

Si uji që del prej kronit
Rrjedh mirsia e Ndue Ftonit
Nuk po di çka t'tham ma par'
Humanist e ndihmëtar

Përhap vlera atdhetare
Me tradit' e bes' shqiptare
Ky Ndue Ftoni djali t'mirit
Zemërbardh si ujt e Kirit

N'Amerik' mendja k'ti djali
Ka nderu Kombin Shqiptar
Për flamur e për Shqipni
I urojmë gjithmon rini

Pergatite nga Ramazan Çeka,
Maj 2015

Në gjithë këtë shtrirje alpine, një vend të veçantë zë Malësia e Madhe e emërtuar kështu që në kohë të hershme, jo vetëm sepse zinte një sipërfaqje të gjërë, por ishte edhe një kështjellë që me kryetrimat e saj i rezistoi të gjitha rrebesheve që historia i vuri në provë.

Për të nderuar personazhin më të spikatur publik të qytetit të Shkodrës, për kontributin e tij në vite në fusha të ndryshme sociale, kulturore dhe artistike të jetës, unë përmes emocioneve të papërskruara thura disa vargje si poezi për ta plotësuar dhe kompletuar më pas edhe me një këngë dedikuar z. Ndue Ftoni, i cili me mençurinë dhe mjeshttrinë e veprave të tij ka bërë një emër si simbol bamirësie.

Në Imperial: "Darka Shkodrane" e shqiptarve të Michigan-it

Për të dytin vit rresht pronari i Qëndres Kulturore Shqiptare "The Imperial House", biznesmeni Ndue Ftoni organizon aktivitetin kulturor "Darka Shkodrane" në Michigan.

Aktiviteti edhe simjet ishte i ideuar në formën e spektaklit muzikor. Ishin të ftuar këngëtarja e njohur Vjollca Luka dhe Arben Delaj, humoristet Besnik Çinari dhe Bujar Ademovi, prezantues aktorja e Teatrit "Migjeni" Shkodra, Rajmonda Marku e ftuar për këtë rast nga Shqipëria dhe Ndue Gjekaj, veprimtar i njohur në komunitetin shqiptar në Michigan të SHBA-së.

Është shfrytëzuar rasti i aktivitetit "Darka Shkodrane" që të inagurohet Qendra Mediatike në funksion të Televizionit të Komunitetit Shqiptar në Michigan "ACT", por që do të shfrytëzohet edhe nga Restoranti "The Imperial House" në rastet e dasmave dhe eventeve të ndryshme kulturore për individ ose shoqata të ndryshme të komunitetit.

Pjesmarrja ishte jo ajo që pritej kështu u shpreh dhe vetë organizatori i "Darkes Shkodrane", biznesmeni Ndue Ftoni

Ai falenderoj pjesmarrësit, por nuk la pa u kujtuar atyre dhe të tjerëve që do ta marrin vesh nga mediat dhe perçimi i lajmit gojor në komunitet, se darka ishte një mundësi për shkoderanet që jetojnë në komunitet për t'u bashkuar dhe për të shijuar këngët, meloditë dhe humorin e pavdekshëm shkoderan. Ai tha- dua të falenderoj mbi dhe nënshkodrakët që nuk hezituan të marrin pjesë në aktivitet, jo vetëm te sotmin, por edhe më parë. Ky fanatizem për të na ndjekur në aktivitetet tona na vën para përgjegjësisë që në të ardhmen të korrigjojmë të metat dhe dobsitë që hasen në kesi rastesh-tha Ftoni në fjalën e tij.

Ajo që ran ë sy ishte dhe pjesmarrja e malesorve të Malësisë Madhe, që vijnë nga trojet e tyre shqiptare që sot janë në administrim shtetror nga Mali i Zi.

Performanca e këngëtarve Vjollca Luka dhe Arben Delaj bëri që të pranishmit ta mbajnë ndezur këngën shkoderane deri vonë, pas mesit të natës.

Po ashtu dhe humorit i Besnik Çinarit dhe Bujar Ademovit ishte i zgjedhur për të pranishmit duke anashkaluar batutat banale që sot janë ulur këmbëkryq në shoë humoristike deri dhe tek televizionet prestigjioze shqiptare.

Besnik Çinari nuk la pa falenderuar qin-

dera e ndoshta mijra Malësor të Malësisë Madhe që janë tifoz fanatik të "Vllaznisë" Shkoder në ditë të mira dhe të veshtrira të saj. Si asnje zonë nuk gjenë një tifozeri fanatike vetem për "Vllazninë"

Duhet theksuar jo vetem për eventin e "Darkes Shkodrane", por edhe për të tjerë që duhet të ruhet më shumë "fanatizmi" i sjelljes së këngëtarve në kesi rastesh.

E thënë ndryshe; megjithëse këngëtarët Vjollca Luka dhe Arben Delaj janë këngëtar klasi për zhanret e tyre por duke mos qënë autokton shkoderane ndoshta ka prekë dhe sedrën e shkoderanve për një pjesmarrje jo të një niveli të kënaqshëm.

Kështu në justifikojmë dhe pjesmarrje më të madhe nga fshatrat Nën dhe Mbishkoder dhe treva të tjera se sa vetë



shkoderan.

Gjithësei edhe me keto mangësi aktivitete të ketij farmati janë të pelqeshme dhe me vlere të shumta.

Pergatite nga Rush DRAGU, Micigan

REDAKSIA

Kryeredaktor: Luigj Shyti

Redaktorë: Lazër Stani, Roza Pjetri, Prelë Milani, Lazër Kodra, Suela Ndoja, Zef Nika, Zef Gjeta, Lulash Brigja

Mundësoi
Botimin:
NDUE FTONI

